



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 702 Akti**

**Nr. 707 Vendimi**  
**Tiranë, më 23.10.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 17.10.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Teuta Rrudha**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket

rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimin Teuta Rrudha, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 17.10.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimin Teuta Rrudha gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimin *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimin Teuta Rrudha i është nënshtruar procedurave të rivlerësimin, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimin, si dhe të caktoj kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimin janë nisur procedurat e rivlerësimin, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimin profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimin të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 18.1.2021 është njoftuar subjekti i rivlerësimin për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimin me anë të postës elektronike të datës 20.1.2023 konfirmoi mospasjen e ndonjë konfliktit të interesit me të tre anëtarët e trupit gjykues.

6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Teuta Rrudha, me vendimin nr. 2, datë 19.9.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Në datën 26.9.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 11.10.2023.
8. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në datën 27.9.2023 pranë Komisionit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike. Subjekti paraqiti prapësimet në datën e caktuar nga Komisioni.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 11.10.2023, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 13.10.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 17.10.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 17.10.2023, me prezencën e subjektit si dhe të përfaqësuesit ligjor, av. M. P., si dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.
11. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti Teuta Rrudha parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 17.10.2023 u mbyll për të rifilluar më 23.10.2023 për shpalljen e vendimit.
12. Pas seancës dëgjimore, në datën 18.10.2023, trupi gjykues me vendimin e ndërmjetëm nr. 4 vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin Teuta Rrudha, për shkak të marrjes dijene të një shkrimi të bërë publik në media – me të cilin subjekti u njoh gjatë seancës dëgjimore dhe iu kërkua të paraqesë dokumentacionin përkatës – që u paraqitën nga subjekti të njëjtën ditë (18.10.2023) lidhur me këtë çështje, si dhe për administrimin e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2023, të mbërritur (me vonesë) nga ASHK Durrës.
13. Kësisoj, Komisioni administroi shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2023, nga ASHK Durrës së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, si dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit me *email*-in e datës 18.10.2023 – konkretisht kërkesën për gjykim të Prokurorisë së Rrethit Durrës lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018 dhe fashikullin hetimor të procedimit penal, si dhe vendimet nr. \*\*\*, datë 17.7.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 16.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës – të cilat i bëri pjesë të dosjes së hetimit administrativ.

14. Me vendimin nr. 5, datë 18.10.2023, Komisioni vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Teuta Rrudha dhe, më pas, i njoftoi subjektin seancën e caktuar për datën 23.10.2023, për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

17. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
18. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
19. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

### 1. Apartament banimi me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vlerën 71.500 euro

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2009 pasurinë e llojit apartament të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, në Durrës, të porositur me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 21.8.2009, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 71.500 euro. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: (i) një kredi në shumën 4.500.000 lekë të marrë në Raiffeisen Bank; (ii) një hua në vlerën 10.000 euro; dhe (iii) dhuratë nga vëllai në shumën 10.000 euro.
2. Në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë e fizikë, të së njëjtës deklaratë subjekti ka deklaruar hua në shumën 10.000 euro, marrë nga një mik i familjes, pa kontratë, pa afat shlyerjeje dhe pa interes. Ndërsa, në rubrikën e të dhënave konfidenciale ajo ka deklaruar dhuratë nga vëllai i saj në shumën 10.000 euro, me burim nga shitja e një apartamenti me sip. 150 m<sup>2</sup>, në qytetin e Fierit, pronë e familjes.
3. Më tej, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e huas në shumën 10.000 euro, por pa përshkruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e saj. Po në këtë deklaratë, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar një detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 1.600.000 lekë, që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes e vitit 2009.
4. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë në analizë me vlerë 71.500 euro, me burim krijimi: (i) kredi bankare në shumën 4.725.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank, në vitin 2009<sup>1</sup>; (ii) hua në shumën 10.000 euro nga shtetasja A. S., sipas deklaratës noteriale<sup>2</sup> të vitit 2011 dhe të likuiduar sipas deklaratës noteriale<sup>3</sup> të vitit 2015; (iii) dhurim në vlerën 10.000 euro nga vëllai M. Rr., sipas deklaratës noteriale<sup>4</sup> të vitit 2017; (iv) detyrim në shumën 1.600.000 lekë, i mbetur pa likuiduar ndaj shoqërisë ndërtuese/shitëse.
5. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka rezultuar një kontratë shitjeje me kusht nr. \*\*\*, datë 23.7.2008, e nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., për shitjen e një apartamenti në katin e 12-të me sipërfaqe rreth 130 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 71.500 euro. Në këtë kontratë citohej se kësti i parë në shumën 15.000 euro ishte likuiduar ditën e nënshkrimit të saj, jashtë zyrës së noterisë, ndërsa këstet e tjera do të likuidoheshin në vijim<sup>5</sup>. Kontrata në fjalë dhe pagesa në shumën 15.000 euro nuk kanë rezultuar të deklaruara në DIPP-në e vitit 2008, nga ana e subjektit.
6. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se për shkak të tipit të kontratës jo në formën e duhur ligjore nuk ishte akorduar kredia nga banka, që do të mundësonte likuidimin e kësteve në vijim. Për rrjedhojë, u përpilua një sipërmarrje në vitin 2009, mes të njëjtëve palë, për të njëjtin apartament dhe të njëjtin çmim.

<sup>1</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 6.10.2009.

<sup>2</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2011.

<sup>3</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 30.12.2015.

<sup>4</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2017.

<sup>5</sup> Referuar kontratës, kësti i dytë në shumën 30.000 euro do të likuidohet deri në momentin e akordimit të një kredie bankare, por jo më vonë se data 31.3.2009; ndërsa kësti i tretë në shumën 26.500 euro do të likuidohet në datën 30.9.2009, me dorëzimin e çelësave të apartamentit.

7. Gjithashtu, bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka rezultuar edhe kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 21.8.2009, ku citohej se: “(i) kësti i parë 15.000 euro është likuiduar totalisht në dorë, jashtë zyrës së noterisë; (ii) kësti i dytë 35.000 euro do të likuidohet në momentin e akordimit të kredisë bankare; (iii) kësti i tretë në shumën 21.500 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit”. Bashkëlidhur kontratës janë evidentuar tri mandatarkëtime, përkatësisht: (i) mandati nr. \*\*\*, datë 21.8.2009, arkëtuar nga Teuta Rrudha 10.000 euro për blerje apartamenti; (ii) mandati nr. \*\*\*, datë 6.12.2009, paguar nga Teuta Rrudha 10.000 euro për blerje shtëpie; dhe (iii) mandati nr. \*\*\*, datë 29.12.2009, arkëtuar nga Teuta Rrudha 4.500.000 lekë për blerje apartamenti.
8. Lidhur me pagesat e kryera ndaj shoqërisë shitëse, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se pavarësisht se në kontratën e vitit 2008 është shënuar që kësti i parë ishte likuiduar dhe nga ana e saj nuk është kryer asnjë pagesë në këtë vit. Sipas subjektit, të gjitha kështet janë likuiduar gjatë vitit 2009. Konkretisht: (i) kësti i parë në shumën 15.000 euro është likuiduar në gusht të vitit 2009 (nga e cila 5.000<sup>6</sup> euro *cash* një ditë përpara lidhjes së kontratës dhe 10.000 euro në ditën e lidhjes së kontratës, sipas mandatit të datës 21.8.2009); (ii) shuma 10.000 euro në datën 6.12.2009; (iii) shuma 4.500.000 lekë (nga kredia) në datën 28.12.2009.
9. Lidhur me detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj palës shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k, në dosjen e ILDKPKI-së ka rezultuar një deklaratë noteriale<sup>7</sup> e administratorit të shoqërisë në fjalë, ku citohet se nga blerësi ende nuk është likuiduar detyrimi prej 1.600.000 lekësh. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se sikurse ka parashtruar edhe në procesverbalin e datës 24.11.2011, të mbajtur nga ILDKPKI-ja, ajo nuk ka qenë në dijeni të detyrimit për të deklaruar shumën e palikuiduar ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka paraqitur një tjetër deklaratë noteriale<sup>8</sup> të administratorit të shoqërisë ku, ndër të tjera, citohej se për shkak se nuk ishte akorduar kredia nga ana e bankës, kontrata me kusht e vitit 2008 ishte revokuar në heshtje. Palët kanë dakordësuar për nënshkrimin mes tyre të një kontrate sipërmarrjeje sipas kërkesave të bankës, për të njëjtin apartament dhe të njëjtën vlerë. Ai ka parashtruar gjithashtu në deklaratën në fjalë se nga znj. Teuta Rrudha ka marrë tri këste, përkatësisht: (i) shumën 15.000 euro (nga e cila 10.000 euro me mandat dhe 5.000 euro pa mandat, nga një ngatërrësë e ekonomistit), kryer në vitin 2009; (ii) shumën 10.000 euro në datën 6.12.2009; (iii) këstin e tretë nga kredia bankare në shumën 4.500.000 lekë, duke shtuar se znj. Rrudha ka ende pa likuiduar shumën 1.600.000 lekë.
10. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe një tjetër deklaratë noteriale<sup>9</sup> për njohje të detyrimit, të nënshkruar mes saj dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku përpos sa është deklaruar në deklaratën e mësipërme, palët janë shprehur se nuk kanë asnjë pretendim tjetër përveç shumës 1.600.000 lekë. Detyrimi në fjalë është konfirmuar edhe nga përmbajtja e procesverbaleve të datave 24.11.2011 dhe 17.3.2016, të mbajtura nga ILDKPKI-ja<sup>10</sup> ku,

<sup>6</sup> Për këtë shumë subjekti ka deklaruar në pyetësorin nr. 2 se nuk disponon mandatpagesë.

<sup>7</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2011.

<sup>8</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.7.2021.

<sup>9</sup> Deklaratë noteriale për njohje detyrimi me nr. \*\*\*, datë 9.7.2021.

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2022. Në këtë shkresë Komisioni ka kërkuar edhe një kopje të DIPP-së së vitit 2003 (e cila nuk ndodhej në dosjen e subjektit). ILDKPKI-ja ka bërë me dije se subjekti nuk e ka dorëzuar këtë deklaratë pranë saj. Ndërsa subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se në DIPP-në e vitit 2003 e ka plotësuar dhe depozituar pranë sekretarisë përkatëse dhe se nuk disponon ndonjë kopje të saj.

ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se deri në datën 31.12.2014 detyrimi i palikuiduar ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. ka qenë në shumën 1.600.000 lekë dhe se mosdeklarimi i këtij detyrimi ka qenë një lapsus.

11. Komisioni ka administruar dosjen e kredisë së paraqitur nga Raiffeisen Bank<sup>11</sup>, në të cilën ka rezultuar një mandat tjetër arkëtimi, me nr. \*\*\*, datë 22.XI.2..., viti është i paqartë, me shënimin “*U arkëtua nga Teuta Rrudha, 10.000 euro*”. Në pjesën e pasme të këtij mandati të firmosur dhe vulosur me vulën e shoqërisë, citohej: “*Shënim: Gjithsej janë paguar 15.000 euro deri në datën 22.9.2009*”.
12. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për saktësimin e të dhënave në mandatarkëtimin dhe/ose paraqitjen e një kopjeje më të qartë të mandatit në fjalë, Raiffeisen Bank<sup>12</sup> ka bërë me dije se nuk mundej të saktësonte datën dhe vitin e mandatit, për shkak se pagesa ishte kryer në arkën e shoqërisë dhe jo në bankë. Banka ka bashkëlidhur mandatarkëtimin, në të cilin sërish nuk evidentohet data.
13. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4 lidhur me arsyet e mosdeklarimit të kësaj pagese në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime të paraqitura edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, duke përsëritur se në vitin 2008 nuk kishte kryer asnjë pagesë dhe duke shpjeguar se fakti se të dy mandatet mbanin të njëjtin numër, \*\*\*, për pagesën 15.000 euro, tregonte që bëhej fjalë për të njëjtën pagesë.
14. Pas kërkesës së Komisionit për të paraqitur mandatpagesat për likuidimin e çmimit të apartamentit në analizë, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.<sup>13</sup> ka konfirmuar informacionin e dhënë më herët nëpërmjet deklaratës noteriale të vitit 2021, si dhe kryerjen e pagesës së vetëm tri kësteve nga ana e subjektit të rivlerësimit sipas kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, shoqëria në fjalë ka bërë me dije se nuk i disponon mandatarkëtimet e kërkuara nga Komisioni për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.
15. FSHU-ja<sup>14</sup> ka konfirmuar një kontratë furnizimi të vitit 2010, në qytetin e Durrësit, në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila përputhej me adresën e apartamentit në analizë, ndërsa UKT-ja<sup>15</sup> ka bërë me dije se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë për kontrata furnizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

### **1.1 Analizimi i burimeve për blerjen e apartamentit**

16. Në vijim paraqitet analiza për secilin këst të paguar, sipas deklarimeve dhe specifikimeve të kryera nga subjekti, si dhe bazuar në dokumentet e administruara nga Komisioni.

#### **1.1.1 Pagesa e këstit të parë 15.000 euro në vitin 2008**

17. Nisur nga fakti që kjo pagesë nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, si dhe nga fakti që deri në këtë vit nga subjekti i rivlerësimit nuk është deklaruar ndonjë gjendje e disponuar *cash* në banesë, që të mund të ishte përdorur si burim për pagesën e këstit të apartamentit, Komisioni – duke iu referuar citimit të kësaj pagese në kontratën me kusht të po këtij viti

<sup>11</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2021.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2023.

<sup>13</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2022.

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021.

<sup>15</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021.

– ka kryer përllogaritjen e kursimeve të mundshme të krijuara përgjatë periudhës 1.1.2008 – 23.7.2008, datë kjo (23.7.2008) në të cilën është nënshkruar kontrata me kusht në fjalë.

18. Komisioni ka konsideruar të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit<sup>16</sup> të saj përgjatë periudhës së analizuar, sipas tërheqjeve të kryera prej tyre nga llogaritë bankare përkatëse, si dhe shpenzimet e familjes përgjatë së njëjtës periudhë. Nga analiza e kryer ka rezultuar se për pagesën e këstit të parë subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -1.756.311 lekë.

### **1.1.2 Pagesa e këstit të dytë 15.000 euro në vitin 2009**

19. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, ka deklaruar se për pagesën e këtij kësti kanë shërbyer 10.000 euro të marra hua nga mikësja e saj A. S.<sup>17</sup>, si dhe 5.000 euro kursime të familjes deri në gusht 2009. Për krijimin e shumës 5.000 euro subjekti ka deklaruar se ka përdorur si burim një kredi konsumatore të marrë nga bashkëshorti i saj në korrik të vitit 2009 pranë Raiffeisen Bank<sup>18</sup>, të cilën nuk e ka deklaruar si burim në DIPP-në e këtij viti.
20. Në këto kushte, ato nuk janë konsideruar nga Komisioni si burim krijimi për këtë pasuri, duke rezultuar kështu në një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -655.700 lekësh (ekuivalenti i këstit të paguar prej 5.000 euro).
21. Më tej, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas së vitit 2009 sipas deklaratës noteriale<sup>19</sup> të vitit 2011, të cilën subjekti e ka bashkëlidhur në deklaratën *Vetting*. Në këtë deklaratë, huadhënësja A. S. ka konfirmuar huan në fjalë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale<sup>20</sup> të vitit 2015, në të cilën huadhënësja ka konfirmuar likuidimin total të huas.
22. QKB-ja<sup>21</sup> ka konfirmuar se znj. A. S. figuron e regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*, me aktivitet noter, regjistruar më 5.2.2003. Në vijim, Komisioni ka administruar nga DRT Durrës<sup>22</sup> dhe nga Bashkia Durrës<sup>23</sup> të dhënat lidhur me fitimin e realizuar dhe taksat dhe tatimet e paguara prej saj.
23. Në mungesë të të dhënave konkrete mbi fitimet e realizuara nga ky aktivitet për periudhën 2000 – 2007, Komisioni ka përllogaritur një mesatare të marzhit të fitimit bruto për periudhën që disponohen të dhënat, 2008 – 2016, nga ku ka rezultuar një mesatare prej 61%, të cilën Komisioni e ka aplikuar edhe në vitet e mëparshme. Pas një përllogaritjeje të fitimit bruto dhe zbritjes së masës së tatimit për biznesin e vogël apo tatimit të thjeshtuar të

<sup>16</sup> Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023, vuri në dispozicion të gjitha lëvizjet e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit T. P. për vitet 2008 dhe 2009.

<sup>17</sup> Identiteti i huadhënësës A. S., mikeshë e familjes, me profesion notere, është cituar në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2011.

<sup>18</sup> Me kontratën e datës 29.7.2009, Raiffeisen Bank i ka akorduar dhe disbursuar subjektit dhe bashkëshortit të saj një kredi në shumën 300.000 lekë, me qëllim për përdorim personal. Bashkëshorti i subjektit ka tërhequr *cash* shumën 278.000 lekë, po në datën 29.7.2009.

<sup>19</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2011.

<sup>20</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 30.12.2015.

<sup>21</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017.

<sup>22</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2017 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.7.2023.

<sup>23</sup> Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017.



fitimit, sipas legjislacioneve në fuqi<sup>24</sup> ka rezultuar se për periudhën 2000 – 2008 personi fizik “A.S.” mund të ketë realizuar potencialisht një fitim neto rreth 6.991.591 lekë.

24. Komisioni, ndër të tjera, ka hetuar për personin fizik “A. S.” edhe në bankat e nivelit të dytë për të qartësuar dhe evidentuar ndonjë investim të mundshëm nga të ardhurat e aktivitetit, nga ku nuk ka rezultuar ndonjë investim apo gjendje e mbetur nëpër llogari.
25. Sipas analizës së kryer rezultoi se pas përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë personi tjetër i lidhur kishte realizuar deri në momentin e dhënies së huas të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, të mjaftueshme për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 1 – Analiza financiare e burimeve të huadhënësit**

Te ardhura nga aktiviteti A.S. 2000 - 2008	6,991,591
Shpenzime jetese 2000 - 2008 (2 persona)	(2,150,316)
Dhene hua subjektit ne vitin 2009	(1,371,700)
<b>Rezultati</b>	<b>3,469,575</b>

26. Lidhur me huan e sipërcituar, trupi gjykues ka analizuar situatën faktike duke mbajtur në konsideratë se pavarësisht se subjekti marrëdhënien e huas nuk e ka formalizuar në formë shkresore për të provuar ekzistencën e saj, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht nenet 1050-1055, nuk parashikohet për efekt të vlefshmërisë së saj një formë e caktuar shkresore. Ndërsa, në këndvështrim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive nga subjekti i rivlerësimit, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>25</sup>, si dhe qëndrimeve tashmë të konsoliduara të Kolegjit<sup>26</sup>, trupi gjykues ka analizuar mundësinë e personit tjetër të lidhur për të realizuar të ardhurat (shumën 10.000 euro) me burime të ligjshme. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>27</sup>, në drejtim të kufijve të hetimit mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.
27. Analiza është fokusuar në periudhën 2000 – 2008, e cila u konsiderua si e arsyeshme të merrej parasysh si për shkak të faktit se për këtë periudhë u administrua dokumentacion ligjor provues për të ardhurat, por edhe për shkak të një arsyetimi logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të saj, por aq sa është e përshtatshme/nevojshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, për sa nuk rezultojnë pretendime apo fakte që e

<sup>24</sup> Ligji nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; ligji nr. 8313 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar; si dhe ligji nr. 9632 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

<sup>25</sup> Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, duke pranuar se marrëdhëniet e pretenduara sipas kësaj dispozite jo detyrimisht duhet të jenë të formalizuara në një formë të caktuar, sigurisht përveç rastit kur forma e tyre është e detyrueshme për vlefshmërinë e tyre, sipas përcaktimit të Kodit Civil, për sa kohë që për provimin e ekzistencës së tyre, në kuptim të këtij procesi kërkohet konfirmimi i personit tjetër të lidhur.

<sup>26</sup> Shihni vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR), nr. 14/2019 (JR) dhe nr. 15/2019 (JR).

<sup>27</sup> Shihni vendimin E. T. nr. 2, datë 2.2.2023, paragrafi 18.8.

lidhin fitimin e saj me një moment të caktuar kohor, me qëllim provimin e ligjshmërisë së burimit për vlerën që është objekt huaje.

28. Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni arrin në konkluzionin se personi tjetër i lidhur justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 10.000 euro të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, konkluzion i cili kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
29. Për sa i përket shlyerjes së huas së sipër trajtuar, Komisioni ka konstatuar se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për likuidimin e huas në fjalë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se huaja është kthyer rreth muajit shkurt të vitit 2015 dhe si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja në vitin 2015 e një apartamenti<sup>28</sup> të ndodhur në qytetin e Fierit. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale<sup>29</sup> të lëshuar nga huadhënësja A. S., e cila ka deklaruar se në korrik të vitit 2009 i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 10.000 euro dhe se kjo shumë është likuiduar prej saj në datën 24.2.2015.
30. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se me anë të kontratës së shitjes me kusht në vitin 2015<sup>30</sup>, subjekti dhe bashkëshorti kanë shitur një apartament të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, kundrejt çmimit 4.500.000 lekë, çmim që do të likuideohej me këste, përkatësisht shuma 500.000 lekë në datën 26.1.2015, shuma 3.150.000 lekë nëpërmjet një kredie bankare dhe shuma 850.000 lekë në momentin e regjistrimit të pasurisë në ASHK Fier.
31. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se në datën 20.2.2015 pala blerëse ka transferuar në favor të subjektit dhe bashkëshortit (në llogarinë e përbashkët në Alpha Bank) shumën 3.150.000 lekë, ku nga kjo shumë bashkëshorti i subjektit ka tërhequr në datën 24.2.2015 shumën 2.000.000 lekë, pra e mjaftueshme për t’i kthyer huan znj. A. S., prej 10.000 euro<sup>31</sup>.

### **1.1.3 Pagesa e këstit të tretë 10.000 euro**

32. Në DIPP-në e vitit 2009 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si një ndër burimet e përdorura për blerjen e apartamentit në analizë shumën 10.000 euro, të dhuruar nga vëllai i saj M. Rr. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale ajo ka detajuar se shuma në fjalë i është dhuruar pa kontratë dhe ka si burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e një apartamenti me sip. 150 m<sup>2</sup> në qytetin e Fierit, pronë e familjes.
33. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale<sup>32</sup> të vitit 2017, në të cilën vëllai i saj ka deklaruar se ai i ka dhuruar motrës së tij Teuta Rrudha shumën

<sup>28</sup> Referuar kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 23.1.2015, me palë blerëse K. dhe D. Dh.

<sup>29</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.7.2021.

<sup>30</sup> Kontrata e shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 23.1.2015.

<sup>31</sup> Komisioni ka administruar nga ASHK Durrës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2023, dokumentacionin në lidhje me investime të mundshme në pasuri të paluajtshme. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni është konstatuar se në vitin 2006 znj. S. ka blerë në datën 17.11.2006 apartamentin me sip. 190 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 1.500.000 lekë. Kjo shumë edhe nëse do të zbritej nga disponibiliteti financiar në shumën e rezultuar 3.469.575 lekë sipas analizës financiare për znj. S., sërisht ajo do të rezultonte me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për mundësimin e huas në vlerën 10.000 euro, të cilën ia ka dhënë subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, është konstatuar se blerja e pasurisë në fjalë është financuar nga një kredi që znj. S. kishte marrë në atë periudhë.

<sup>32</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2017.

- 10.000 euro, si pjesë takuese nga shitja e një apartamenti të përfituar nga privatizimi në vitin 1993 prej tij, subjektit dhe nënës së tyre.
34. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se apartamenti në fjalë është shitur sipas kontratës së shitjes në vitin 2011<sup>33</sup> të nënshkruar mes palës shitëse V. Rr., Teuta Rrudha dhe M. Rr. – të përfaqësuar<sup>34</sup> nga ky i fundit – dhe palës blerëse P. H., kundrejt çmimit të përshkruar në kontratë prej 3.129.484 lekësh.
  35. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me shumën 10.000 euro subjekti ka deklaruar se 600.000 lekë i janë transferuar nëpërmjet bankës në shkurt të vitit 2009 dhe pjesa tjetër prej 5.500 euro i janë dhënë *cash* në muajin shtator 2009.
  36. Subjekti ka shpjeguar se për pagesën e kështit të dytë prej 10.000 euro ka përdorur shumën e dhuruar nga vëllai prej 5.500 euro dhe 4.500 euro nga kursimet e familjes së saj deri në dhjetor të vitit 2009. Subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale të datës 6.9.2008 të vëllait të saj M. Rr. Në këtë deklaratë ai ka deklaruar se në emër edhe të të përfaqësuarve të tij, pasurinë me sip. 79.7 m<sup>2</sup>, së bashku me shtesën prej 70 m<sup>2</sup> ia ka shitur shtetasit B. H. Ai ka deklaruar gjithashtu se nga shitja ka marrë shumën 5.000.000 lekë.
  37. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se ajo dhe nëna e saj kishin hequr dorë nga pasuria në fjalë dhe nga të ardhurat që mund të krijoheshin nga shitja e saj, vëllai i saj e ka ndjerë si detyrim moral që ta ndihmonte për blerjen e banesës në Durrës. Në vijim, ajo ka shpjeguar se pas largimit të saj për në qytetin e Durrësit në vitin 2002, për sa kohë ia kishte lënë të gjitha kompetencat vëllait të saj për këtë pasuri, ajo nuk di detaje mbi shtesa, prishje të banesës apo transaksione të mëtejshme me të.
  38. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar mospërputhje midis momentit të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në vitin 2011 dhe periudhës së pretenduar të likuidimit të çmimit në vitin 2008. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2008, subjekti nuk e ka deklaruar shitjen e pasurisë në bashkëpronësi në vlerën 5.000.000 lekë.
  39. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga bankat për llogaritë bankare të vëllait të subjektit, z. M. Rr., konkretisht në Alpha Bank (sot OTP Bank) është konstatuar se në datën 8.9.2008 është transferuar shuma 3.500.000 lekë nga z. P.H. (pala blerëse në kontratën e shitjes së vitit 2011), me përshkrimin “Sipas kërkesës së klientit”. Më tej, z. Rr. ka tërhequr një pjesë të këtyre fondeve dhe një shumë prej 600.000 lekësh është transferuar në muajin shkurt 2009 në llogarinë e subjektit.
  40. Ndonëse vëllai i subjektit mund të ketë arkëtuar një shumë më të lartë në vitin 2008 për shitjen e kësaj pasurie, duket se detyrimet tatimore për të ardhurat nga shitja janë paguar për vlerën 3.129.484 lekë, sipas përcaktimeve në kontratën e shitblerjes së vitit 2011. Për rrjedhojë, Komisioni ka njohur si të ardhura të ligjshme vetëm pjesën takuese prej 1/3 të çmimit të përmendur në kontratën e shitblerjes, prej 1.043.161 lekësh. Nisur nga fakti që shuma 600.000 lekë është transferuar në llogarinë e subjektit dhe nuk është tërhequr prej

<sup>33</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 23.12.2011.

<sup>34</sup> Me anë të prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 4.6.2008, subjekti i rivlerësimit dhe nëna e saj V. Rr. kanë caktuar përfaqësues z. M. Rr. për t'i përfaqësuar ato në akte të ndryshme noteriale, përfshirë edhe shitjen e pasurisë në bashkëpronësi të tyre, të ndodhur në Fier.

saj së paku deri në vitin 2010, duket se shuma e mbetur e mundshme për t'u përdorur për likuidimin e këstit të dytë të blerjes së apartamentit ka qenë 443.161 lekë.

41. Komisioni ka përllogaritur mundësinë për të kryer pagesën e këstit të tretë prej 10.000 euro deri në datën 6.12.2009, duke përfshirë e konsideruar shumat e tërhequra nga llogaritë e tyre të pagave, si dhe shpenzimet e familjes përgjatë të njëjtës periudhë, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej - 606.174 lekësh.
42. Së bashku me përgjigjet e mësipërme subjekti ka deklaruar se nga një preventiv i kryer nga inxh. V. V. vlera e investimit të kryer në shtesën e banesës ka qenë rreth 872.012 lekë dhe ndërtimi i saj është kryer me kontributin e familjes së saj ndër vite e, konkretisht, të ardhurat e nënës nga pagat e saj dhe të vëllait e bashkëshortes së tij, por nuk ka paraqitur preventivin në fjalë.
43. Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit, nëpërmjet postës elektronike, subjekti ka paraqitur preventivin me vlerë 873.493 lekë, në të cilin nuk evidentohet për çfarë pasurie, periudhe apo sipërfaqeje është kryer kjo përllogaritje. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor mbi ndryshimet e ndodhura ndër vite të strukturës ndërtimore të sipërfaqes shtesë të apartamentit në bashkëpronësi, me qëllim përcaktimin e periudhës së ndërtimit dhe përllogaritjes së kostove të këtij ndërtimi. ASIG-u, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2023, ka paraqitur ortofotot<sup>35</sup> për këtë pasuri nga ku ka rezultuar se në datën 26.4.2001 (datë kjo kur janë kryer fotografimet ajrore nga ASIG-u) shtesa e sipërfaqes ndërtimore në të gjithë gjatësinë e pallatit është e përfunduar. Pra, brenda periudhës që subjekti i rivlerësimit ishte ende pjesë e familjes së saj të origjinës.
44. Komisioni ka përllogaritur koston e ndërtimit të sipërfaqes shtesë prej 70 m<sup>2</sup>, duke konsideruar çmimin maksimal të referencës së EKB-së së vitit 2000<sup>36</sup>, për qytetin e Fierit, prej 21.202 lekë/m<sup>2</sup>. Vlera totale prej 1.484.140 lekësh është përfshirë në analizën financiare të familjes së origjinës së subjektit, nga e cila ka rezultuar se ata kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e këtij ndërtimi shtesë.

**Tabela nr. 2** – Analiza financiare për ndërtimin e sipërfaqes shtesë nga familja e origjinës

Te ardhura nga paga e subjektit 1995 - 2000	1,817,076
Te ardhura nga pensioni i nënes 1995 - 2000	313,002
Te ardhura nga shitja e pasurise ne Fier (trashegimi) 1998	800,000
Shpenzime jetese per 3 persona 1995 - 2000	(737,882)
Kosto ndertimit te siperfaqes shtese 70 m2	(1,484,140)
<b>Rezultati</b>	<b>708,056</b>

#### 1.1.4 Pagesa e këstit të fundit me burim nga kredia bankare

45. Në DIPP-në e vitit 2009, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit të ndodhur në Durrës edhe një kredi bankare të marrë në Raiffeisen Bank.

<sup>35</sup> Ortofoto për pasuritë e kërkuara datojnë nga vitet 1994, 2001, 2007, 2015 dhe 2019.

<sup>36</sup> Përllogaritur kjo në mungesë të informacionit nga ASHK Fier për periudhën e ndërtimit.

46. Raiffeisen Bank<sup>37</sup> ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit është akorduar një kredi për blerje shtëpie në shumën 4.725.000 lekë, me anë të kontratës së kredisë<sup>38</sup> së vitit 2009. Për sigurimin e kësaj kredie është vendosur garanci hipotekore një apartament<sup>39</sup> në emër të shtetasve M. B. dhe kushërirës së saj E. B.<sup>40</sup>. Subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të lëshuar nga znj. B.<sup>41</sup> ku ajo ka është shprehur se në vitin 2009 së bashku me z. B. i kanë ofruar apartamentin në pronësi të tyre që prej datës 7.5.2003<sup>42</sup> si garanci për kredinë që do të merrej prej subjektit.
47. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të kredisë ka rezultuar se disbursimi i kredisë në shumën 4.725.000 lekë është kryer në datën 30.10.2009, ndërsa në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. është transferuar shuma 4.400.000 lekësh në datën 28.12.2009.
48. Subjekti ka paraqitur një mandat për pagesën e shumës 4.500.000 lekë në datën 29.12.2009. Pra, përpos shumës së transferuar nëpërmjet llogarisë bankare, është paguar edhe diferenca prej 100.000 lekësh *cash*. Komisioni ka përllogaritur edhe mundësinë për kursimin e kësaj shume me burime të ligjshme financiare, nga ku ka rezultuar një mungesë prej -80.742 lekësh sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr. 3 – Analiza financiare e pagesës së këstit të tretë**

Te ardhura nga paga e subjektit 7.12.2009 - 29.12.2009	25,000
Te ardhura nga paga e b/shortit 7.12.2009 - 29.12.2009	41,000
Shpenzime te kredise konsumatore	(9,200)
Shpenzime jetese 7.12.2009 - 29.12.2009	(22,542)
Shpenzime qiraje 7.12.2009 - 29.12.2009	(15,000)
Transferuar nga kredia bankare	4,400,000
Paguar kesti i apartamentit 4.500.000 leke	(4,500,000)
<b>Rezultati në 29.12.2009</b>	<b>(80,742)</b>

49. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe dokumente, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri, si vijon:
- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 nënshkrimin e kontratës së shitjes me kusht, kontratë kjo që nuk është revokuar nga palët, si dhe pagesën e kryer në këtë vit prej 15.000 euro.*
  - *Duket se për pagesën e këstit të parë prej 15.000 euro, të kryer në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -1.756.311 lekësh.*
  - *Duket se për pagesën e këstit të dytë prej 15.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e shumës 10.000 euro,*

<sup>37</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2021.

<sup>38</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 6.10.2009.

<sup>39</sup> Pasuria me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në Plazh, Durrës.

<sup>40</sup> Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka bërë me dije se znj. E. B. është e afërmja e saj (vajza e xhaxhait).

<sup>41</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.7.2021.

<sup>42</sup> Sipas certifikatës së pronësisë të paraqitur bashkëlidhur deklaratës.

me burim nga huaja nga znj. A. S. Ndërsa për diferencën prej 5.000 euro, për sa kohë kursimet familjare nuk ishin deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2009 e as në deklaratën Vetting, duket se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të gjithë shumën, prej -655.700 lekësh.

- Duket se ka mospërputhje midis deklaramit të subjektit në DIPP-në e vitit 2009 dhe në deklaratën Vetting, sa i përket shumës 10.000 euro të pretenduar si të dhuruar nga vëllai e të përdorur për blerjen e pasurisë në analizë, në krahasim me shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve dhe asaj të rezultuar nga dokumentacioni i administruar.
- Duket se për pagesën e këstit të tretë prej 10.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -606.174 lekësh.
- Duket se për plotësimin e këstit të fundit prej 4.500.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej -80.742 lekësh.
- Duket se për blerjen e pasurisë në analizë subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë totale të burimeve të ligjshme financiare, në masën -3.098.927 lekë.
- Duket se ka mospërputhje midis shumës së paguar nga çmimi i apartamentit në analizë, referuar dokumentacionit të administruar nga hetimi, në krahasim me atë të deklaruar nga subjekti, pasi duket se ajo nuk ka ndonjë detyrim të papaguar (të pretenduar në shumën 1.600.000 lekë) ndaj shoqërisë shitëse. Po ashtu, edhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e saj nga viti 2009 e deri në vitin 2011 (pasi është thirrur për herë të parë nga ILDKPKI-ja) ndonjë detyrim të mbetur ndaj shoqërisë shitëse për apartamentin në analizë, nga ku Komisioni ngre dyshime mbi kohën e pagesave të kryera, çmimin total të paguar prej subjektit, si dhe vërtetësinë e deklarameve të saj mbi këtë pasuri.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

50. Subjekti ka parashtruar se gjatë vitit 2008 nuk është kryer asnjë pagesë. Shënimi në këtë kontratë për likuidimin e shumës 15.000 euro është kryer në mirëbesim midis palëve me qëllim marrjen e kredisë bankare. Në kontratë gjendet gjithashtu shënimi: “Kësti i dytë në shumën 30.000 euro do të likuidohet deri në momentin e akordimit të një kredie, por jo më vonë se data 31.3.2009”. Subjekti ka sqaruar se duke qenë se kredia nuk u mundësua, kontrata nr. \*\*\*, datë 23.7.2008, u konsiderua pa efekte, pavarësisht se formalisht nuk u revokua. Për rrjedhojë, sipas subjektit, nuk ekziston mungesa e burimeve të ligjshme financiare në shumën -1.756.311 lekë në vitin 2008, sikurse ka përlllogaritur Komisioni.
51. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në shumën -655.700 lekë, për pagesën e shumës 5.000 euro (pjesë e këstit prej 15.000 euro), për shkak se në deklaratën Vetting nuk është deklaruar burimi i krijimit të këtij kësti, subjekti është shprehur se pranon pasaktësinë e kryer në deklaratën Vetting dhe në DPV. Por, sipas saj, kjo pasaktësi nuk është e lidhur me pamjaftueshmëri financiare. Subjekti ka parashtruar se për pagesën e këstit në fjalë, ajo ka pasur një balancë pozitive në vlerën 69.637 lekë.
52. Lidhur me shumën 10.000 euro, e cila i është dhuruar nga vëllai në vitin 2009, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 6.9.2008, ku vërtetohet fakti që ai ka realizuar të ardhura në shumën 5.000.000 lekë nga shitja e pasurisë me sip. 79.7 m<sup>2</sup>, si dhe një shtesë

prej 70 m<sup>2</sup> bashkëngjitur kësaj prone. Kontrata e shitjes është nënshkruar në vitin 2011, vetëm për pasurinë e regjistruar me sip. 79.7 m<sup>2</sup>, ndërsa për shtesën kontrata formale do të bëhej pas legalizimit, ndonëse *de facto* prona disponohej nga blerësi, i cili e kishte likuiduar plotësisht shumën për blerjen e pasurisë (përfshirë edhe shtesën që, sipas deklaramit të subjektit, vijon të jetë e palegalizuar).

53. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të arkëtuara në avancë për shtesën e palegalizuar me sip. 70 m<sup>2</sup> në shumën 1.870.516 lekë (pra diferenca 5.000.000 lekë - 3.129.484 lekë që është vlera e pasurisë së regjistruar), duke iu referuar deklaratës së vitit 2008 kemi të bëjmë me një veprim juridik me kusht. Momenti i realizimit të së ardhurës për efekte tatimore, në këtë rast, do të jetë në momentin kur do të realizohet kontrata e shitblerjes, pra është e ardhur për të cilën nuk ka lindur ende detyrimi tatimor. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se një pjesë e shumës së dhuruar nga vëllai i saj ka shërbyer për të shtuar gjendjen e likuiditetit në bankë (pra, është kursyer), ndërkohë që një pjesë e kursimeve nga të ardhurat e vitit ka shërbyer për kryerjen e pagesave.
54. Subjekti ka parashtruar se pamundësia financiare e vetme e saj ka qenë në masën 216.639 lekë. Ajo ka shpjeguar se kjo diferencë negative rezulton për shkak se ajo asnjëherë nuk ka deklaruar kursimet *cash*; për shkak të luhatjes së kursit të këmbimit gjatë vitit, si dhe për shkak se nuk ka deklaruar edhe të ardhurat nga interesat e depozitës dyemërore, të cilat ndonëse *de jure* deri në vitin 2010 i dispononte së bashku me nënën, subjekti është shprehur se nëna e ka konsideruar depozitën në fjalë si depozitë të subjektit. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 28.2.2022, të nënës së saj, në të cilën kjo e fundit ka deklaruar se i ka kaluar në datën 6.4.2010 vajzës së saj nëpërmjet llogarisë bankare shumën 1.000.000 lekë.
55. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se i detyrohet shoqërisë së ndërtimit në shumën 1.600.000 lekë, detyrim i cili është deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

56. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, analizimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe provave të paraqitura prej saj lidhur me pasaktësitë në deklarime periodike, për të cilat subjekti është shprehur se pranon pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike të saj, por, sipas saj, këto pasaktësi nuk lidhen me pamjaftueshmëri financiare, Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>43</sup>, çmon se këto pasaktësi, për sa kohë rezultojnë të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi penalizuese subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.
57. Lidhur me pagesën e kështit të parë prej 15.000 euro, sipas kontratës me kusht të vitit 2008, ndonëse në fazën e hetimeve paraprake, Komisioni kishte konstatuar se përveçse ajo (pagesa) nuk ishte deklaruar nga subjekti kishte rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej -1.756.311 lekësh. Sikurse u parashtrua më sipër, subjekti e ka prapësuar këtë konstatim pas kalimit të barrës së provës, duke pretenduar, ndër të tjera, se në vitin 2008 nuk ka kryer asnjë pagesë. Konkretisht rezulton se realisht kontrata me kusht

---

<sup>43</sup> Shihni vendimet e Kolegjit: nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021; nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021; nr. 10/2022, paragrafi 25.6.

e vitit 2008 - pikërisht me kushtëzimin e vlefshmërisë vijuese të saj, me marrjen e kredisë nëpërmjet kësaj kontrte (*conditio sine qua non*), - nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik dhe është mbivendosur dhe zëvendësuar *de facto* nga kontrata e porosisë/sipërmarrjes e vitit 2009, e cila është lidhur midis të njëjtave palë, me të njëjtin objekt (pasurinë në analizë) dhe me të njëjtin çmim. Kësisoj, Komisioni vlerëson se ndonëse palët nuk e kanë revokuar formalisht kontratën me kusht të vitit 2008, për sa kohë nuk është plotësuar kushti (pezullues) dhe, për më tepër, *de plano* marrëveshja dhe transaksioni lidhur me pasurinë në fjalë është transferuar totalisht në kontratën e vitit 2009 – ku nuk citohet ndonjë pagesë e kryer në vitin 2008 – dhe në mungesë të ndonjë prove të kryerjes reale të kësaj pagese në vitin 2008, ky rezultat nuk rezultoi mjaftueshëm i provuar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë një penalizim për subjektin e rivlerësimit. Kjo edhe për faktin se, vetë kontrata e vitit 2009 shprehet për pagesën e kështit të parë në atë vit, duke përjashtuar kësaj ndonjë pagesë të kryer në vitin 2008. Për më tepër që në pjesën e pasme të mandatpagesës së kështit të parë, përshkruar më sipër, ka një shënim ku vetë administratori i shoqërisë ndërtuese/shitëse specifikon se deri në muajin shtator 2009 nga pala porositëse *de qua* janë paguar vetëm 15.000 euro. Edhe kjo rrethanë, parë në harmoni me provat e tjera – që përshkruhen edhe në vijim – përforcon besueshmërinë e pretendimit të subjektit, duke krijuar bindjen se në vitin 2008 nuk është kryer pagesa e lartpërmendur.

58. Gjithashtu, për të qartësuar panoramën lidhur me pagesat në analizë, vërehet se pas shqyrtimit të provave dhe analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të përcaktimit të kohës së kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit në analizë, trupi gjykues ka konstatuar sa vijon:

- i) Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti nuk ka deklaruar pagesë të kryer për blerjen e apartamentit. Po ashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar asnjë e dhënë (veprim bankar) lidhur me ndonjë pagesë të kryer nga subjekti në favor të palës shitëse, por ka rezultuar vetëm një kontratë shitjeje me kusht, si dhe një mandatpagesë me nr. \*\*\*, pjesë e dosjes së bankës, në të cilën subjekti ka aplikuar për kredi për blerjen e apartamentit. Kontrata e vitit 2008 nuk ka prodhuar asnjë efekt dhe është konsideruar e revokuar në heshtje, për shkak të mosplotësimit të kushtit (marrjes së kredisë).
- ii) Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes së datës 21.8.2009, si dhe pagesat e kryera sipas specifikimeve të saj gjatë vitit 2009, në shumën 71.500 euro për blerjen e apartamentit. Bazuar edhe në udhëzimet e bankës, subjekti dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë nënshkruar kontratën në fjalë, me të njëjtin objekt, me ndryshimin e vetëm që ishte emërtimi nga kontratë me kusht në kontratë sipërmarrjeje, në të cilën specifikohet se kësti i parë prej 15.000 euro është likuiduar.
- iii) Fakti se çmimi për blerjen e apartamentit është likuiduar brenda vitit 2009, përveçse në DIPP-në e vitit 2009, është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting* edhe përgjatë procesit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës pas përfundimit të hetimeve nga Komisioni.
- iv) Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka dorëzuar mandatpagesat për shumat e paguara ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Mandati i datës 22.9.2009, së bashku me shënimin



përkatës, dëshmon se në shoqëri janë paguar gjithsej vetëm 15.000 euro deri në këtë datë. Pra, me sa duket, shoqëria ka dashur të zëvendësojë mandatin e mëparshëm, duke prodhuar një mandatarkëtim të ri mbi bazën e mandatit nr. \*\*\*, datë 21.8.2009, me të njëjtin numër, me të njëjtën përmbajtje me atë të ndodhur në dosjen e bankës.

- v) Po ashtu, nga procesverbalet për marrjen në pyetje të subjektit nga ILDKPKI-ja, konkretisht ai i datës 24.11.2011, i cili ka ndrequr pasaktësinë e DIPP-së së vitit 2009, si dhe procesverbali i datës 17.3.2016, në të cilin citohet detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë në shumën 1.600.000 lekë, përbëjnë provë në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe është vlerësuar si i tillë edhe në qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit<sup>44</sup> ku, ndër të tjera, citohet se: “... *përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfuara në këtë dokument, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësitë në deklarime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit*”.
- vi) Pala shitëse, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., në mënyrë të përsëritur përmes disa deklaratave noteriale<sup>45</sup> ka konfirmuar deklaratimet që ka bërë subjekti gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me kryerjen e pagesave përgjatë vitit 2009, si dhe detyrimin e mbetur pa likuiduar nga subjekti.
- vii) Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se pasuria në analizë nuk është regjistruar në ASHK-në Durrës. Objekti ku ndodhet ky apartament ka pësuar dëmtime të konsiderueshme nga tërmeti i vitit 2019. Punimet për rindërtimin e tij vijojnë edhe ditët e sotme. Këto rrethana, në një farë mënyre justifikojnë faktin e moslikuidimit total të detyrimit të mbetur pa likuiduar, çka krijojnë bindjen mbi vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit sa i takon shumave të paguara dhe detyrimit të mbetur.
59. Në analizë të sa më sipër, si dhe referuar edhe qëndrimin të mbajtur në një rast të ngjashëm nga Kolegji<sup>46</sup>, duke mbajtur në konsideratë se kontratat paraprake të porosisë/të sipërmarrjes mund të jenë objekt ndryshimi sipas vullnetit të lirë të palëve, ndonëse në rastin konkret nuk ka ndryshuar as objekti dhe as palët, por vetëm titulli i kontratës në fjalë, në funksion edhe të mundësisimit të marrjes së një kredie, sikurse ka ndodhur në vitin 2009, për sa i përket përcaktimit të kohës së shlyerjes së shumave, sipas kontratës së datës 21.8.2009, trupi gjykues e konsideron bindës shpjegimin e subjektit se pagesat janë kryer të gjitha gjatë vitit 2009.
60. Parashikimi i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, veç këstit të parë, të paguar para lidhjes së kontratës, është bërë për veprime që do të ndodhnin në të ardhmen, pra nuk konfirmohet një rrethanë faktike që ka ndodhur tashmë. Në këtë kuptim, këto afate konsiderohen si orientuese për palët nënshkruese dhe nuk kanë fuqinë e provueshmërisë së momenteve konkrete kur është kryer shlyerja e shumave, për sa kohë

<sup>44</sup> Në vendimin nr. 37/2021, paragrafi 10.21.

<sup>45</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2011; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.7.2021; deklaratë noteriale për njohje detyrimi me nr. \*\*\*, datë 9.7.2021.

<sup>46</sup> Vendimi nr. 20 (JR), datë 31.7.2019, paragrafi 40.

flitet për parashikim. Sigurisht që palët udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të modifikojnë marrëveshjet me dakordësim mes tyre mbi afatet dhe të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët – siç ka ndodhur edhe në rastin konkret, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vazhdimisht se pagesat janë kryer të gjitha gjatë vitit 2009 dhe se kishte një detyrim financiar të mbetur pa u likuiduar në masën 1.6 milionë. Gjithashtu, edhe vetë shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. nëpërmjet deklaratave noteriale të përsëritura të saj ka mbështetur me sqarimet e saj pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë fakt.

61. Ky konkluzion i Komisionit është në harmoni edhe me faktin se kontrata e vitit 2008 është revokuar në heshtje mes palëve dhe shuma 15.000 euro është konsideruar përsëri si këst i parë në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2009. Nëse do të pranohej se shuma në fjalë ishte paguar sipas kontratës së vitit 2008, së paku në kontratën e vitit 2009 do të citohehin kësti i dytë e me radhë ato vijues. Pra, prezumimi i një pagese të kryer në vitin 2008 mbetet i pabazuar në fakte e prova.
62. Për sa i përket faktit se kontrata e vitit 2008 nuk ka rezultuar e revokuar formalisht nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se revokimi formal i kontratës nuk ka qenë një domosdoshmëri në rastin konkret, për sa kohë palët kanë qenë në mirëbesim dhe kontrata në fjalë *de jure* nuk prodhonte efekte as për palët dhe as për të tretët. Bazuar në nenin 84 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe vendimin nr. 37, datë 24.1.2012, të Gjykatës së Lartë, citohet se: “*Mosvërtetimi i ngjarjes (kushtit), përmbushjes së detyrimit për kryerjen e investimit ka si pasojë mossjelljen e efekteve të vetë veprimit juridik*” {... *pasojat juridike të vërtetimit ose jo të kushtit, në veprimet juridike që e kanë pjesë atë (kushtin), vijjnë vetiu (ipso jure) pa qenë nevoja që palët të bëjnë ndonjë veprim. Në rastin e mosvërtetimit të kushtit pezullues, veprimi juridik nuk fiton fuqi juridike, ai konsiderohet sikur nuk është kryer*}”.
63. Nisur nga fakti se subjekti kishte rënë dakord me palën shitëse për likuidimin e kësteve për blerjen e apartamentit sipas një planifikimi kohor që kushtëzohej nga marrja e kredisë prej saj, për sa kohë kredia nuk u akordua nga banka, kontrata e vitit 2008 është revokuar (*de facto*) në heshtje nga palët – si një *modus operandi* që asokohe ishte e përhapur, në kushte të ngjashme.
64. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson të konsiderojë se pagesa e këstit të parë prej 15.000 euro është kryer deri në datën 21.8.2009, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, si dhe siç ka rezultuar nga mandatpagesa e kësaj date. Për rrjedhojë, shuma totale e paguar në vitin 2009 është 25.000 euro dhe 4.500.000 lekë (e konvertuar në total në 7.850.800 lekë) dhe detyrimi i mbetur pa paguar është rreth 1.560.030 lekë, - çka përputhet me deklarimin e subjektit se kanë mbetur pa likuiduar edhe 1.600.000 lekë.
65. Në lidhje me burimet e ligjshme të subjektit, të përdorura për likuidimin e kësteve të apartamentit në analizë, trupi gjykues vlerëson të analizojë deklaratimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratën periodike të vitit 2009, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni*”. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit, siç është përshkruar më lart, ka përcaktuar se si burim i pagesës së shumës 71.500 euro kanë shërbyer: huaja në shumën

10.000 euro e dhënë nga personi tjetër i lidhur znj. A. S.; shuma 10.000 euro, dhuruar subjektit prej vëllait të saj; një kredi e marrë prej saj në Raiffeisen Bank.

66. Komisioni analizoi prapësimet e subjektit dhe shqyrtoi provat e paraqitura lidhur me çështjet për të cilat i kishte kaluar barrën e provës, duke konstatuar sa vijon:

a) Lidhur me mundësinë financiare të subjektit për të përballuar me burime të ligjshme pagimin e shumës 5.000 euro një ditë përpara lidhjes së kontratës së porosisë (datë 20.9.2009), si dhe shumën 10.000 euro sipas mandatpagesës datë 21.8.2009. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë konsideruar të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit<sup>47</sup> të saj përgjatë periudhës së analizuar, sipas tërheqjeve të kryera prej tyre nga llogaritë bankare përkatëse, si dhe kredia e tërhequr në datën 29.7.2009 nga bashkëshorti i subjektit në shumën 278.000 lekë. Në përfundim ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr. 4** – Analiza financiare për krijimin e kursimeve në vlerën 5.000 euro

Te ardhura nga paga e subjektit 1.1.2009 - 20.8.2009	539,000
Te ardhura nga paga e b/shortit 1.1.2009 - 20.8.2009	290,000
Terhequr nga kredia konsumatore ne RZB	278,000
Shpenzime jetese 1.1.2009 - 20.8.2009	(261,627)
Shpenzime qiraje 1.1.2009 - 20.8.2009	(120,000)
Shpenzime udhetimi 1.1.2009 - 20.8.2009	-
Paguar kesti i apartamentit 5.000 euro	(655,700)
<b>Rezultati në datë 20.8.2009</b>	<b>69,673</b>

67. Ndërsa pjesa tjetër e kështit të parë prej 15.000 euro është justifikuar me burime të ligjshme nga huaja që subjekti ka marrë nga mikeshja e saj A. S., në shumën 10.000 euro, sikurse është konkluduar edhe në rezultatet e hetimit paraprak.

b) Lidhur me pagesën e kështit të dytë në shumën 10.000 euro, pas kalimit të barrës së provës subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të shumës 10.000 euro të dhuruar nga vëllai i saj. Komisioni, pas analizimit të prapësimeve të subjektit dhe shqyrtimit të provave të paraqitura prej saj, duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit<sup>48</sup> mbi kufijtë e shtrirjes së analizës financiare për personin tjetër të lidhur, nisur nga fakti se nga hetimi rezultoi se vëllai i subjektit ka disponuar edhe të ardhura të tjera të mjaftueshme për dhurimin e shumës 10.000 euro, ka konkluduar që në fazën e hetimeve paraprake se vëllai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhurimin e shumës në fjalë.

68. Komisioni ka rillogaritur mundësinë e subjektit për të kryer pagesën e kështit të tretë prej 10.000 euro deri në datën 6.12.2009, duke përfshirë ndër të tjera edhe shumën 771.700<sup>49</sup> të dhuruar nga vëllai (diferenca e shumës së dhuruar *cash* nga vëllai, duke qenë se 600.000

<sup>47</sup> Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2023, dërguar në rrugë elektronike, vuri në dispozicion të gjitha lëvizjet e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit T. P. për vitet 2008 dhe 2009, të padërguara më herët prej tyre.

<sup>48</sup> Vendimi nr. 2, datë 2.2.2023, paragrafi 17.12.

<sup>49</sup> Komisioni ka konvertuar shumën 10.000 euro të dhuruar nga vëllai i subjektit, sipas kursit të këmbimit të vitit 2009 (10.000\*137.17=1.371.700 lekë), (1.371.700-600.000= 771.700 lekë).

lekë subjekti i ka pasur gjendje në llogarinë e saj bankare) dhe për sa kohë parashikimi ligjor për deklarimin e gjendjes *cash*, nis nga viti 2003 – *ex nunc*.

- c) Lidhur me kursimet *cash*, me burim nga të ardhurat nga interesat e depozitës dyemërore, që subjekti dispononte së bashku me nënën, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se deri në vitin 2002 ka disponuar shumën 399.101 lekë, si dhe deri në datën 6.12.2009 shumën 59.565 lekë. Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin bankar, si dhe ka analizuar mundësinë potenciale të kursimit nga interesat e shumave të pretenduara nga subjekti. Nga verifikimi i llogarisë bankare në fjalë, si dhe pas analizës së kryer ka rezultuar se nëna e subjektit ka kryer tërheqje të interesave nga depozita, në periudhat dhe në shumat e pretenduara nga subjekti. Për rrjedhojë, burimi i ligjshëm i tyre rezultoi i provuar me dokumentacion ligjor të paraqitur.
69. Për sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare për pagesën e shumës 10.000 euro nga subjekti, duke përfshirë të ardhurat në shumën 771.200 lekë, të dhuruar nga vëllai, si dhe të ardhurat në shumën 59.565 lekë nga interesat bankarë (për periudhën kur është paguar shuma në fjalë).
70. Duke u nisur nga stadi që ishin konsideruar në rezultate (-606.174 lekë), në raport me të ardhurat shtesë të pretenduara nga subjekti, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit për pagesën e kështit 10.000 euro ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -218.570 lekësh, - *dura lex, sed lex* - siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 5 – Analiza financiare për pagesën e shumës 10.000 euro**

Te ardhura nga paga e subjektit 21.8.2009 - 6.12.2009	336,500
Te ardhura nga paga e b/shortit 21.8.2009 - 6.12.2009	112,000
Te mbetura nga periudha e meparshme	69,673
Dhurate nga vëllai subjektit	771,200
Të ardhura nga interesat e depozitës	59,565
Shpenzime per kredine 21.8.2009 - 6.12.2009	(18,600)
Shpenzime jetese 21.8.2009 - 6.12.2009	(125,007)
Shpenzime qiraje 21.8.2009 - 6.12.2009	(45,000)
Paguar kesti i apartamentit 10.000 euro	(1,378,900)
<b>Rezultati në 6.12.2009</b>	<b>(218,570)</b>

71. Në konkluzion, për sa i përket kësaj pasurie, Komisioni çmon se bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, duke mbajtur në konsideratë masën e pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar, ky rast nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të përbëjë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

## **2. Pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit, të përfituara nga trashëgimia**

72. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se në emër të subjektit të rivlerësimit Teuta Rrudha figuron e regjistruar pasuria e llojit truall me nr. \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, \*\*\*, Lushnjë.

73. ZVRPP Lushnjë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2017, ka bërë me dije se në pasurinë e sipërcituar me sip. 790 m<sup>2</sup>, znj. Teuta Rrudha figuron në kartelën e pasurisë me bashkëpronarët e tjerë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj pasurie ka rezultuar se me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.1995, për kthimin dhe kompensimin e pronave të z. T. Rr., KKKP Lushnjë ka vendosur t'u njohë trashëgimtarëve të tij kthimin e një sipërfaqeje prej 4.000 m<sup>2</sup> dhe kompensimin për një sipërfaqe prej 5.000 m<sup>2</sup>. Me anë të dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 25.4.1994, janë përcaktuar trashëgimtarët e z. T. Rr., mes të cilëve edhe subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë një ndër trashëgimtarët e radhës së parë.
74. Komisioni i Piketimit të Pronave i Bashkisë Divjakë, në datën 5.10.2003 ka bërë zbatimin e vendimit dhe nga sipërfaqja totale prej 4.000 m<sup>2</sup> iu kthye fizikisht një sipërfaqe prej 800 m<sup>2</sup>. Nga kartela e pasurisë ka rezultuar se pasuria është në bashkëpronësi të 33 personave, mes të cilëve edhe subjekti i rivlerësimit.
75. Ndërkohë, nga shqyrtimi i deklaratave periodike të dorëzuara ndër vite, por edhe asaj *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjërën prej tyre. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegimet e saj mbi arsyet e mosdeklarimit të bashkëpronësisë në pasurinë e sipërcituar, duke bërë me dije gjithashtu nëse mbi të është kryer ndonjë investim i mundshëm.
76. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje është shprehur se pasuria rrjedh nga trashëgimia e babait të saj, i cili ka ndërruar jetë në vitin 1989 dhe se ajo nuk ka pasur dijeni për pasuritë që mund të kishte pasur babai i tij (gjyshi i subjektit). Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ajo është njohur me këtë pasuri vetëm pas pyetësorit të Komisionit, duke konstatuar se është përfituese e 1/33 pjesë dhe se aktualisht aty jetojnë kushërinjtë e saj, të cilët kanë investuar mbi këtë truall një godinë trekatëshe.
77. Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 9.7.2021, të të afërmit të saj L. Rr., i cili ka deklaruar se ka ndërtuar mbi këtë pasuri një godinë 3-katëshe me sip. 144 m<sup>2</sup>, ku kati i parë është lokal dhe kati i dytë e i tretë janë për banim, të regjistruara në emër të tij dhe bashkëshortes V. Rr., me nr. pasurie \*\*\*, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës.
78. Po ashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka paraqitur foto të objektit, koordinatat dhe pozicionin e tij në *Google Maps*<sup>50</sup>, nga ku dallohet një godinë e ngritur 3-katëshe. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk ka dijeni për praktikën e ndjekur dhe se nuk ka asnjë lidhje aktuale me këta të afërm apo pasuritë në fjalë.
79. Komisioni ka kërkuar informacion mbi fotografimet ajrore nga ASIG-u për këtë pasuri. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ky institucion me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2023, ka informuar se nuk mund të identifikojë territorin në të cilin gjendet zona kadastrale 1492, pasi nuk zotëron informacion gjeohapësinor nga ASHK-ja.
80. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime lidhur me mosdeklarimin në asnjë nga DIPP-të nga viti 2004, si dhe në deklaratën *Vetting* të pjesës takuese në masën 1/33 të pasurisë në fjalë, në bashkëpronësi.

---

<sup>50</sup> [https://maps.app.goo.gl\\*\\*\\*](https://maps.app.goo.gl***)

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

81. Subjekti ka parashtruar se është vënë në dijeni përmes pyetësorit të Komisionit për faktin se është përfituese e 1/33 pjesë, pasi nuk ka asnjë lidhje faktike me pasuritë në fjalë.
82. Lidhur me mosdeklarimin e të drejtave pasurore nga trashëgimia në deklaratat periodike dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka pretenduar se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, për sa kohë ajo nuk ka dhënë ndonjë kontribut financiar për të përfituar të drejtat pasurore në fjalë.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

83. Komisioni, pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit, në analizë dhe logjikë të pretendimeve të saj – duke pasur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit<sup>51</sup> – theksohet se pasaktësia në fjalë (që në rastin konkret mund të ketë qenë edhe si pasojë e mungesës së dijenisë), për sa kohë nuk lidhet me ndonjë kontribut financiar të subjektit dhe kështu duke qenë e pashoqëruar me pamjaftueshmëri financiare apo me problematika në burimin e krijimit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore. Gjithashtu, duke pasur parasysh: (i) origjinën e krijimit të kësaj pasurie; (ii) faktin se subjekti nuk ka kontribuar financiarisht në krijimin e saj; (iii) se pasuria nuk ka rezultuar të jetë përdorur ndonjëherë nga subjekti dhe bazuar në gjithë sa u arsyetua më sipër – trupi gjykues krijoi bindjen lidhur me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe ndonjëse ky mosdeklarim është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk konsiderohet i mjaftueshëm për t’u kualifikuar sipas nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

### **3. Truall me sipërfaqe 292 m<sup>2</sup>, në Fier, në pronësi të bashkëshortit**

84. Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi një truall me sip. 292 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, të përfituar nga trashëgimia e prindërve të tij. Kjo pasuri në vitin 2013 i është dhënë për ndërtim shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes<sup>52</sup>, me qëllim ndërtimin e një pallati shumëkatësh. Në vijim, mes palëve është nënshkruar edhe një aneks kontrate sipërmarrjeje<sup>53</sup>, po i vitit 2013, nga e cila prej subjektit dhe bashkëshortit është përfituar një sipërfaqe ndërtimore prej 603 m<sup>2</sup>.
85. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Fier<sup>54</sup> ka rezultuar se ky truall me sip. 292 m<sup>2</sup> i është kaluar në pronësi bashkëshortit të subjektit, me anë të kontratës<sup>55</sup> për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Fier, ku është përshkruar se kjo Drejtori garanton kryerjen e procedurave të regjistrimit për parcelën ndërtimore dhe objektin e ngritur në të sipas lejes së legalizimit, pasi ka përmbushur detyrimet në bazë të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
86. Nga dokumentacioni ka rezultuar se për këtë pasuri, sipas lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 18.9.2012, për bashkëshortin e subjektit, z. T. P., është miratuar legalizimi i objektit godinë banimi dhe shërbimi 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi 64.3 m<sup>2</sup>, e përbërë nga 54.2 m<sup>2</sup> për banim

<sup>51</sup> Vendimi nr. 35, datë 22.9.2022.

<sup>52</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 25.5.2013.

<sup>53</sup> Aneks kontratë nr. \*\*\*, datë 9.9.2013.

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2022.

<sup>55</sup> Kontratë për kalimin e parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, datë 31.8.2012.

dhe 10.1 m<sup>2</sup> për aktivitet, për të cilën bashkëshorti kishte aplikuar me anë të formularit të vetëdeklarimit për legalizim objekti nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2006.

87. Duke qenë se në formularin e vetëdeklarimit nuk kishte të dhëna mbi kohën e ndërtimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bënte me dije mbi periudhën gjatë së cilës është kryer ndërtimi në fjalë, duke paraqitur dokumentacionin që provon vlerën e shpenzimeve të kryera, përfshirë edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura. Në përgjigjet e saj, ajo ka deklaruar se sipas dokumentacionit të paraqitur për procedurat e legalizimit ndërtimi në fjalë është përfunduar në vitin 2000 me kontributin e bashkëshortit dhe familjes së tij të origjinës, ndërkohë që ajo është martuar në vitin 2002.
88. Gjithashtu, ajo ka paraqitur një dokument ku me anë të një kërkesë të datës 1.9.2012 bashkëshorti i saj i është drejtuar një vlerësuesi inxhinier ndërtimi për të hartuar një akt ekspertimi për qëndrueshmërinë e objektit, duke i dhënë të dhënat se ndërtimi është kryer në vitin 2000 pa projekt-zbatim dhe me specialistë të thjeshtë të marrë prej tij. Inxh. M. S. në raportin e tij ka konkluduar se: *“...ndërtimi është konform kushteve teknike të ndërtimit dhe garanton qëndrueshmërinë e tij, [...] pasi ky ndërtim është përfunduar dhe vënë në shfrytëzim për më shumë se 11 vjet dhe nuk ka pasur asnjë problem konstruktiv”*.
89. Sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale nga ALUIZNI ka rezultuar se vlera e investimit është përlllogaritur në masën 1.829.537 lekë, ndërkohë që subjekti është shprehur se kjo vlerë është e përlllogaritur për vitin 2012 dhe jo për periudhën kur është kryer ndërtimi. Ajo ka paraqitur edhe një preventiv nga inxh. V. V., i cili është shprehur se kostoja e ndërtimit të objektit të mësipërm ka qenë 617.078 lekë.
90. Ndër të tjera, subjekti është shprehur se për shkak se ky investim ishte kryer përpara martesës së saj, nga informacionet në familje kishte krijuar idenë se trualli ku ishte kryer ndërtimi ka qenë pronë e familjes P. dhe më tej është vënë në dijeni se për të janë ndjekur procedurat e legalizimit. Po ashtu, subjekti ka paraqitur dy foto/plane nga ASIG-u të vitit 1994 dhe më pas të vitit 2001.
91. Nga ortofotot e paraqitura nga ASIG-u<sup>56</sup> duket se që në vitin 1994 ka pasur gjurmë të një sipërfaqeje ndërtimore, e cila duket se ka ndryshim me sipërfaqen ndërtimore në pamjet e vitit 2001. Më pas, në fotot e mëtejshme të vitit 2007, së paku me sy të lirë nuk evidentohet ndonjë ndryshim thelbësor, përveçse në pamjet e vitit 2015, ku duket ndërtimi i pallatit shumëkatësh mbi këtë pasuri. Nga sa më sipër, duket se ndërtimi është përfunduar brenda vitit 2001, përpara lidhjes së martesës së subjektit me bashkëshortin në gusht të vitit 2002.
92. Lidhur me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për ndërtimin e saj, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se si të ardhura kanë shërbyer kryesisht të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit si mësues për vitet 1984 – 1997, ndërsa për vitet 1997 – 2001 kanë shërbyer të ardhurat nga puna e tij si emigrant, por ajo nuk mund të provojë me dokumentacion ligjor punësimin e tij në emigracion, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.
93. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në ndonjë nga deklaratat periodike të dorëzuara prej saj deri në vitin 2013, kur ka deklaruar lidhjen e një kontrate sipërmarrjeje me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., duke vënë në dispozicion

---

<sup>56</sup> Shkesë nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2023.

të shoqërisë sipërfaqen e truallit 500 m<sup>2</sup> (që i përkiste vjehrrit të saj) dhe sipërfaqen e truallit 292 m<sup>2</sup> që u përkiste atyre.

94. Referuar kontratës së sipërmarrjes, bashkëpronarët do të përfitonin 25% të sipërfaqes ndërtimore, nga ku subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në shkëmbim të truallit të tyre do të përfitonin një sipërfaqe ndërtimore prej 603 m<sup>2</sup>, përkatësisht 2 garazhe, 2 dyqane dhe 5 apartamente, përfshirë edhe ambientet e përbashkëta. Në vitin 2018 është nënshkruar edhe kontrata e shkëmbimit<sup>57</sup> mes tyre.
95. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe dokumente për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri lidhur me mosdeklarimin e ekzistencës së ndërtimit, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2004 e deri në vitin 2013 dhe formës së deklarimit, sa i takon mënyrës së përfitimit të kësaj pasurie.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

96. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur informacionin e duhur mbi aktin juridik të përfitimit të kësaj pronësie. Ajo ka pranuar faktin e pasaktësisë së kryer nga bashkëshorti në deklaratën *Vetting*, për mënyrën e fitimit të kësaj pronësie, por, në kushtet kur nuk konstatohen problematika në burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe në kushtet kur kjo pasuri është krijuar përpara martesë, kjo pasaktësi, sipas subjektit, mbetet e karakterit formal.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

97. Trupi gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore, duke marrë në konsideratë: (i) faktin se në vitin 2016 është paraqitur në ILDKPKI, si dhe i është bashkëlidhur deklaratës *Vetting* i gjithë dokumentacioni për përfitimin e godinës së banimit; (ii) faktin që kjo pasuri është krijuar përpara martesë; (iii) faktin se subjekti nuk ka dhënë asnjë kontribut në krijimin e kësaj pasurie, vlerëson se mosdeklarimi në këtë rast përbën një pasaktësi, e cila në vetvete nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit. Ky arsyetim i trupit gjykues mbështetet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit për pasuritë e krijuara përpara martesë, konkretisht në vendimin nr. 19/2022, në të cilin, ndër të tjera, arsyetohet: “[...]24. 1. Kolegji çmon se periudha në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka investuar për ndërtimin e banesës në rr. “{\*\*\*}”, ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore dhe kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë. {...} Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të situatës së mësipërme faktike, çmon se problematikën e konstatuar lidhur me pasurinë banesë në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...]”.
98. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se sa është konstatuar nga Komisioni më sipër, në rastin konkret nuk passjell ndonjë implikim për subjektin e rivlerësimit në kuadër

<sup>57</sup> Nr. \*\*\*, datë 29.9.2018.



të procesit të rivlerësimit. Kjo, për sa kohë u provua se origjina e pasurisë tokë truall mbi të cilën ishte ngritur godinë banimi dhe shërbimi, rrjedh nga një akt i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Fier, ku është përshkruar se kjo Drejtori garanton kryerjen e procedurave të regjistrimit për parcelën ndërtimore dhe objektin e ngritur në të sipas lejes së legalizimit, pasi ka përmbushur detyrimet në bazë të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, dhe se nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk është ngritur asnjë dyshim për përfshirje të paligjshme të subjektit të rivlerësimit në këtë proces. Nga ana tjetër, edhe në vendimin nr. 14/2021, Kolegji ka theksuar: *“Sa i takon shpenzimet të kryer nga bashkëpronarët për ndërtimin e murit i cili ka mundësuar shtesën e sipërfaqes prej 12,5 m<sup>2</sup>, në vlerën monetare prej 146.000 lekësh, trupi gjykues, pasi verifikoi legjislacionin e zbatueshëm për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, konstatoi se subjekti i rivlerësimit në vitin 2008, kur edhe ka ndodhur ky ndërtim pa leje (referuar formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, si dhe pohimit të subjektit në seancën e datës 10.6.2021 gjatë gjykimit në Kolegji), nuk ndodhej në kushtet e detyrimit për deklarim të këtij shpenzimi, për sa kohë detyrimi për deklarim i shpenzimeve të kryera në masën e caktuar nga ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2012”*.

99. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pasaktësia lidhur me (mos)deklarimin e pasurisë në rastin *de quo* nuk mund të përbëjë shkak për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi penalizuese, për sa kohë nuk u konstatuan problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

#### **4. Automjet tip “Mercedes-Benz”**

100. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri të llojit automjet fillimisht në DIPP-në e vitit 2015<sup>58</sup>, me targë \*\*\*, të blerë në shtetin gjerman me anë të faturës së shitjes nr. \*\*\*, datë 1.7.2015, kundrejt çmimit 4.500 euro, me burim nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, deklarim ky i përsëritur edhe në deklaratën *Vetting*. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale të DIPP-së së vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se shpenzimet e transportit, doganës dhe regjistrimit për automjetin në fjalë kanë kushtuar rreth 400.000 lekë.
101. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, ka bërë më dije se në emër të shtetasit T. P. rezulton i regjistruar automjeti me të dhënat e mësipërme, i vitit të prodhimit 2006, duke bashkëlidhur dosjen e mjetit. Bashkëshorti i subjektit ka kryer edhe zhdoganimin e automjetit në fjalë, në datën 4.7.2015, kundrejt tarifës së zhdoganimit prej 131.251 lekësh. Nga sa më sipër, duket se kostoja totale e automjetit ka qenë 1.019.425 lekë.
102. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se me anë të kontratës së shitjes me kusht nr. \*\*\*, datë 23.1.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë shitur një apartament të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, kundrejt çmimit 4.500.000 lekë. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se në datën 20.2.2015 pala blerëse ka transferuar në favor të subjektit dhe bashkëshortit të saj shumën 3.150.000 lekë. Nga kjo shumë, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr në datën 24.2.2015 shumën prej

---

<sup>58</sup> Në DIPP-në e vitit 2015 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shitjen e automjetit ekzistues tip “Mercedes-Benz” me anë të kontratës nr. \*\*\* (automjet i blerë në vitin 2003 në shtetin gjerman në shumën 1.300 euro, paguar zhdoganimi 148.000 lekë dhe i deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 me vlerën 600.000 lekë), datë 17.11.2015, kundrejt çmimit 100.000 lekë.

2.000.000 lekësh, me anë të së cilës ka deklaruar se i ka kthyer huan znj. Spahiu, prej 10.000 euro. Ai ka tërhequr më pas, në datën 24.3.2015, edhe shumën 1.000.000 lekë, e cila së bashku me shumën e mbetur pas likuidimit të huas (623.500 lekë) duket e mjaftueshme për të mbuluar çmimin e blerjes, transportit dhe zhdoganimit të automjetit në analizë.

103. Në përfundim të sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e pasurisë, si dhe me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

#### **5. Depozitë bankare në shumën 1.000.000 lekë, në Raiffeisen Bank**

104. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë bankare në Raiffeisen Bank, në shumën 1.000.000 lekë. Ajo ka shpjeguar se kjo depozitë është krijuar në vitin 1987 në Bankën e Kursimeve e, më pas, është transferuar në Raiffeisen Bank. Subjekti ka shtuar se depozita është plotësuar në këtë shumë në vitin 1999 dhe deri në muajin prill 2009 ka qenë në emër të nënës së saj e më pas nga muaji prill 2010 depozita ka kaluar në emër të subjektit. Për krijimin e kësaj depozite subjekti ka bërë me dije se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga puna e nënës së saj si mjeke ndër vite, nga puna e saj si prokurore dhe nga të ardhurat nga shitja e një apartamenti në qytetin e Fierit në vitin 1998.

105. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2021, ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një depozitë në shumën 1.000.000 lekë, të investuar për herë të parë në datën 6.4.2010 e më pas të riinvestuar çdo vit, së paku deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Kjo shumë i është transferuar subjektit të rivlerësimit nga llogaria e nënës së saj V. Rr., në datën 6.4.2010, me përshkrimin “Kalim”.

106. Nga dokumentacioni i administruar nga Raiffeisen Bank duket se depozita në shumën 1.000.000 lekë është çelur nga nëna e subjektit për herë të parë në datën 2.4.2007.

107. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit ndër vite ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2005 ajo ka deklaruar depozitën në shumën 1.000.000 lekë, me pjesë takuese 50%, por pa dhënë detaje mbi burimin e kësaj depozite. Komisioni ka konstatuar se ajo nuk ka deklaruar tërheqjen e kësaj shume në vitin 2005 dhe as destinacionin e kësaj shume e, po ashtu, në DIPP-në e vitit 2010 nuk është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit as depozita dhe as dhurimi i pretenduar nga ana e nënës. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se depozita e deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting* është e njëjtë me atë të deklaruar në vitin 2005 dhe se në konceptin e saj ishte e deklaruar një herë.

108. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në fjalë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 – sikurse ishte shprehur edhe më herët në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 24.11.2011 – subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se depozita është krijuar shumë kohë më parë, prej vitit 1987, dhe se ajo ka qenë dyemërore, në emër të saj dhe të nënës së saj, e çelur fillimisht në Bankën e Kursimeve e më pas në Raiffeisen Bank.

109. Në vijim, Komisioni iu drejtua Raiffeisen Bank, duke i kërkuar të paraqiste dokumentacionin mbi depozitën e lartpërmendur. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2023, ka informuar se në emër të subjektit dhe nënës së saj ka qenë një depozitë kursimi dyemërore e vitit 1998, e çelur me shumën 300.000 lekë, si dhe një depozitë kursimi nr. \*\*\*, datë 23.9.1987, për të cilën disponohen të dhëna deri në datën

15.6.1997, kur gjendja e saj ka qenë 133.512 lekë dhe se nuk disponohen të dhëna për depozitime, tërheqje apo data e mbylljes së depozitës.

110. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank ka rezultuar se në datën 1.10.2004 është kaluar teprica nga Banka e Kursimeve e depozitës në shumën 1.017.960 lekë. Komisioni ka përlllogaritur mundësinë për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e familjes së origjinës së subjektit, deri në korrik të vitit 2002, përpara martesës së subjektit. Në vijim të analizës financiare të kryer nga Komisioni ka rezultuar se ata kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -79.919 lekësh për çeljen e depozitave në fjalë.
111. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, për të paraqitur shpjegime lidhur me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2005 të tërheqjes së depozitës në shumën 1.000.000 lekë dhe destinacionin e saj, mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2010 të shumës 1.000.000 lekë të dhuruar nga nëna e saj, si dhe në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme financiare prej -79.919 lekësh, për krijimin e kësaj depozite.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

112. Subjekti ka sqaruar se kjo depozitë i ka fillesat që nga viti 1987. Në datën 1.10.2004 është kaluar teprica nga Banka e Kursimeve e depozitës në shumën 1.017.960 lekë, në Raiffeisen Bank. Subjekti ka pretenduar se në analizën e kryer nga Komisioni është përlllogaritur mundësia për krijimin e kësaj depozite me të ardhurat e familjes së origjinës, deri në korrik të vitit 2002, përpara martesës dhe në këtë analizë nuk janë vendosur të ardhurat nga interesat bankarë për periudhën në fjalë në shumën 399.101 lekë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

113. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, bazuar edhe në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2023, të Raiffeisen Bank, bashkëlidhur së cilës gjendej një kartelë, sipas së cilës ka rezultuar se interesi i maturuar dhe tërhequr nga depozitat ka variuar nga 26% në vitin 1998 deri në 6,3% në vitin 2003. Vetëm nga përlllogaritja e interesave rezulton se në periudhën 1998 – 2003 nga kjo depozitë, *ex ante*, janë përfituar interesa në shumën 348.571 lekë. Nga lëvizja e llogarisë e datës 5.10.2023 konstatohet se kjo llogari ka pasur tepricë 1.017.960 lekë që në datën 30.9.2004, periudhë kur Raiffeisen Bank bleu Bankën e Kursimeve.
114. Gjithashtu, *idem*, ka rezultuar se disa shuma si interesa janë përfituar dhe tërhequr edhe nga depozita e çelur në vitin 1987, ku banka ka përcjellë të dhënat për interesat e përfituar në vitet 1995 – 1997, që janë në shumën 50.530 lekë. Pra, nëse shtojmë interesat e përfituar nga të dyja depozitat e kursimit, shuma rezulton në vlerën totale 399.101 lekë.
115. Duke u nisur nga stadi që ishin konsideruar në rezultatet e njoftuara pas mbylljes së hetimit administrativ, në raport me të ardhurat shtesë të pretenduara nga subjekti, Komisioni, nisur nga: (i) marrëdhënia e posaçme nënë e bijë; (ii) koha kur janë çelur depozitat, parë edhe në raport me statusin e subjektit në atë kohë – jo subjekt; (iii) fakti që të ardhurat u provuan me dokumentacion ligjor – e konsideron bindës dhe të pranueshëm pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të këtyre të ardhurave.
116. Për sa më sipër, Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin bankar, si dhe ka analizuar

mundësinë potenciale të kursimit nga interesat e shumave të pretenduara nga subjekti dhe ka konstatuar se interesat nga depozita, në periudhën 1995 – 2000, arrijnë vlerën 154.729 lekë, ndërsa për periudhën 2001 – korrik 2002 të ardhurat nga interesat kanë qenë në vlerën 25.626 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një bilanc pozitiv të burimeve të ligjshme financiare prej 862.785 lekësh, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 6** – Analiza për përlogaritjen e mundësisë së krijimit të shtesës 70 m<sup>2</sup>

Te ardhura nga paga e subjektit 1995 - 2000	1,817,076
Te ardhura nga pensioni i nenes 1995 - 2000	313,002
Te ardhura nga interesat e depozites	154,729
Te ardhura nga shitja e pasurise ne Fier (trashegimi) 1998	800,000
Shpenzime jetese per 3 persona 1995 - 2000	(737,882)
Kosto ndertimit te siperfaqes shtese 70 m2	(1,484,140)
<b>Rezultati</b>	<b>862,785</b>

**Tabela nr. 7** – Analiza për krijimin e depozitës bankare

Te ardhura nga paga e subjektit 2001 - korrik 2002	807,438
Te ardhura nga pensioni i nenes 2001 - korrik 2002	150,440
te ardhura nga interesat e depozitës	25,626
E mbetur nga periudha e meparshme	862,785
Shpenzime jetese 2001 - korrik 2002 (3 persona)	(445,854)
Investuar nga nena ne depozite ne B. Kursemeve	(300,000)
Krijuar depozite ne shumen 1.000.000 leke	(1,000,000)
<b>Rezultati</b>	<b>100,436</b>

117. Në konkluzion lidhur me këtë depozitë, nisur nga rrethanat specifike të lartpërmendura dhe kryesisht nga marrëdhënia e posaçme familjare nënë - bijë, duke u vlerësuar në harmoni me të gjitha faktet e rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se mosdeklarimi i të ardhurave nga interesat bankarë në raport me mungesën e burimit të ligjshëm financiar të konstatuar (në një shumë relativisht të ulët), nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

### REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

118. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

119. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat për pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës (të përfitimit), të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, i bashkëngjitur deklaratës

*Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve gjendja e likuiditeteve, shpenzimet jetike, si dhe shpenzimet e arsimimit dhe të udhëtimeve, sipas rishikimeve të kryera, në funksion të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, kur ato kanë rezultuar të bazuara mbi dokumentacion provues dhe janë vlerësuar bindëse nga rrethanat dhe faktet e provuara edhe në mënyrë të tërthortë.

120. Nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara për kriterin e pasurisë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

121. Subjekti ka pretenduar se balanca negative e konstatuar në rezultatet e hetimit ka rezultuar për shkak se Komisioni ka përllogaritur si të paguar shumën 15.000 euro në vitin 2008, si dhe në vitin 2009 nuk ka përfshirë në analizë të gjithë vlerën e dhuruar nga vëllai dhe një diferencë tjetër për krijimin e depozitës, e cila nuk ekziston. Ajo ka pretenduar se e vetmja pamundësi financiare e saj është ajo e vitit 2009, në vlerën 247.974 lekë. Kjo diferencë sipas subjektit rezulton për arsye si vijon:

- për shkak se asnjëherë nuk ka deklaruar *cash*;
- nuk ka deklaruar edhe të ardhurat nga interesat e depozitës, të cilën e ka pasur së bashku me nënën dhe që i kanë kaluar subjektit;
- për shkak të luhatjes shumë të madhe të kursit të këmbimit gjatë vitit 2009 në fillim të vitit, kursi i këmbimit ka qenë në shumën 131 lekë dhe në fund të vitit rreth 137 lekë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

122. Komisioni çmon se lidhur me analizën financiare për gjithë periudhën e rivlerësimit, 2003 – 2016, duke u nisur nga stadi që ishin konsideruar në rezultate, të riparë në raport me: moskonsiderimin e pagesës së hipotetizuar si të kryer në vitin 2008; konsiderimin e të ardhurave shtesë, të pretenduara e të provuara nga subjekti, pasi janë marrë në konsideratë të ardhurat nga interesat bankarë të tërhequra është rishikuar shuma e të ardhurave të disponueshme, të dhuruara nga vëllai (sikurse është arsyetuar më sipër – ndonëse edhe nëse nuk do të rishikohej ky burim pamundësia financiare e konstatuar fillimisht prej 606.174 lekësh nuk do të ishte përcaktuese për një vendimmarrje të ndryshme) – ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej - 247.974 lekësh, siç është detajuar në analizën financiare të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

### **Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

Viti	Deri 2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>2,805,885</b>	<b>18,478</b>	<b>-1,018,079</b>	<b>-52,038</b>	<b>58,425</b>	<b>124,567</b>	<b>8,537,020</b>	<b>199,608</b>	<b>-7,293</b>	<b>-7,439</b>	<b>2,505</b>	<b>-141,951</b>	<b>1,251,440</b>	<b>-569,871</b>
Automjet Mercedes Benz	321,745													
Apartament banimi 130 m2 ne Durres							7,850,800							
Automjet													750,676	
Apartament banimi ne b/proneti ne Fier	1,484,140													
Ndrysishim likuiditeti	1,000,000	18,478	-1,018,079	-52,038	58,425	124,567	686,220	199,608	-7,293	-7,439	2,505	-141,951	500,764	-569,871
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>1,000,000</b>	<b>1,018,478</b>	<b>399</b>	<b>-51,639</b>	<b>6,787</b>	<b>131,353</b>	<b>817,573</b>	<b>1,017,181</b>	<b>1,009,888</b>	<b>1,002,450</b>	<b>1,004,954</b>	<b>863,003</b>	<b>1,363,768</b>	<b>793,896</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,396,700</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>321,098</b>	<b>372,000</b>	<b>-1,376,500</b>	<b>0</b>
Kredi prane Raiffeisen Bank							4,725,000							
Hua nga A. S.							1,371,700						-1,376,500	
Kredi konsumatore ne Raiffeisen Bank											321,098			
Kredi konsumatore ne BKT													267,000	
Kredi konsumatore ne BKT													105,000	
<b>PASURI NETO</b>	<b>2,805,885</b>	<b>18,478</b>	<b>-1,018,079</b>	<b>-52,038</b>	<b>58,425</b>	<b>124,567</b>	<b>2,140,320</b>	<b>199,608</b>	<b>-7,293</b>	<b>-7,439</b>	<b>-318,593</b>	<b>-513,951</b>	<b>2,627,940</b>	<b>-569,871</b>
<b>Te ARDHURA dokumentuar</b>	<b>4,774,139</b>	<b>867,476</b>	<b>846,259</b>	<b>1,179,239</b>	<b>1,186,037</b>	<b>961,528</b>	<b>2,909,605</b>	<b>2,543,712</b>	<b>1,675,171</b>	<b>1,828,808</b>	<b>1,776,821</b>	<b>1,961,326</b>	<b>5,746,396</b>	<b>2,120,574</b>
Te ardhura nga paga e subjektit	3,490,229	611,440	499,443	851,115	880,706	854,656	1,039,958	1,044,760	1,136,093	1,283,559	1,214,323	1,388,730	1,409,756	1,522,913
Te ardhura nga paga e b/shorrit	303,575	256,036	283,139	328,124	305,331	106,872	438,382	477,293	497,683	508,474	532,126	569,452	583,672	597,575
Te ardhura nga shifja e pasurise	800,000												3,650,000	
Te ardhura nga shifja e automjetit													100,000	
Te ardhura nga interesat e depozitave bankare	180,335		63,677				59,565	21,659	41,395	36,775	30,372	3,144	2,968	86
Dhurate nga vella							1,371,700							
Dhurate nga nena								1,000,000						
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,855,761</b>	<b>281,592</b>	<b>343,671</b>	<b>658,870</b>	<b>637,530</b>	<b>611,611</b>	<b>1,017,260</b>	<b>1,597,228</b>	<b>1,390,260</b>	<b>1,659,681</b>	<b>1,350,085</b>	<b>1,653,790</b>	<b>2,063,184</b>	<b>1,853,633</b>
Shpenzime jetese	1,457,506	281,592	328,671	328,671	369,266	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	586,661	304,621	489,775
Shpenzime mobilimi	120,000						310,000						600,000	500,000
Shpenzime te kredise bankare ne RZB							369,120	646,425	612,382	607,339	588,929	528,329	494,547	489,984
Shpenzime per arsimimin e vajzes									52,000	54,000	57,000	60,000	72,000	162,000
Shpenzime per legalizimin e objektit									403,806					
Shpenzime te kredive konsumatore RZB							58,279	110,942	108,103	107,837	131,626	327,850		
Shpenzime te kredive konsumatore BKT												81,595	123,268	143,928
Shpenzime udhetimi				150,199	88,264	21,751			207,916	63,626	149,458	69,354	96,098	67,946
Shpenzime qiraje			15,000	180,000	180,000	180,000	180,000	120,000						
Shpenzime te tjera	278,255													172,651
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>112,493</b>	<b>567,406</b>	<b>1,520,667</b>	<b>572,407</b>	<b>490,082</b>	<b>225,351</b>	<b>-247,974</b>	<b>746,877</b>	<b>292,204</b>	<b>176,566</b>	<b>745,329</b>	<b>821,487</b>	<b>1,055,271</b>	<b>836,812</b>
Gjende cash / kursane nga perioda meparshme														500,000
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>														<b>-247,974</b>

123. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, vlerëson se znj. Teuta Rrudha ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar, ku rezultoi të ishte e përfshirë. Kësisoj, trupi gjykues çmon se mungesa e këtyre burimeve – me balancë negative minimale të mjeteve monetare – nuk përbën shkak të mjaftueshëm për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe përcaktimit të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

124. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Teuta Rrudha, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2017 – pa përgjigjen e njërit prej organeve verifikuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit për vazhdimin e detyrës.
125. Komisioni, me shkresën e datës 8.6.2022, i ka kërkuar AKSIK-së përditësimin e raportit në fjalë lidhur me përgjigjen e munguar dhe mbi informacione të tjera të mundshme.
126. AKSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2022, i ka bërë me dije Komisionit se edhe pas informacioneve të tjera të mbërritura nga institucionet verifikuese konfirmohet konstatimi për përshtatshmëri të subjektit, sikurse konkludohej në raportin e sipërcituar, i cili më vonë është deklasifikuar në datën 8.9.2022 me vendimin nr. \*\*\* të KDZH-së.
127. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të hetimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në informacionet dhe dokumentet e administruara, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Teuta Rrudha, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ajo ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të

papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, subjekti arrin një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

128. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Teuta Rrudha, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
129. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
130. Raporti i përcjellë nga KLP-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
131. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka rezultuar se për periudhën e rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016 ka qenë me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>59</sup>.
132. Nga KLP-ja është bërë me dije, ndër të tjera, se emri i shtetas Teuta Rrudha është përmendur gjatë kryerjes së hetimeve në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2014, i cili nuk ka emër të regjistruar. Pas përfundimit të hetimeve është vendosur pushimi i këtij procedimi.
133. Ndaj shtetas Teuta Rrudha është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2016, për të cilin pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
134. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar këto ankesa për prokuroren Teuta Rrudha:
  - Ankesa nr. \*\*\*, datë 10.8.2018, e shtetasit T. Q. – në këtë ankesë ankuesi ka pretenduar se vendimi i pushimit të procedimit penal të marrë nga prokurori në lidhje me kallëzimin e paraqitur prej tij nuk ishte i drejtë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2018, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun i ka kthyer përgjigje shtetasit T. Q., duke i bërë me dije se bazuar në ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në

---

<sup>59</sup> Prokurorja Teuta Rrudha ka deklaruar se numri i çështjeve të caktuara tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës është: gjithsej 693 çështje të përfunduara; gjithsej 457 procedime penale të përfunduara dhe 236 materiale verifikuese, të trajtuara gjatë tri vitet e fundit të detyrës; gjithsej 19 çështje të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës.

Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm nuk ka më kompetencë në kontrollin e veprimtarisë së prokurorive të rretheve.

- Ankesa nr. \*\*\*, viti 2018, e shtetases F. L. – në këtë ankesë kjo shtetase ankohet në lidhje me një kallëzim penal, për të cilin prokurorja Teuta Rrudha kishte vendosur mosfillimin e procedimit me vendimin nr. \*\*. Ankuesja e kishte paraqitur ankesën e saj tek institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm dhe kërkonte që ky vendim mosfillimi të shfuqizohej. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2018, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun i ka kthyer përgjigje shtetases F. L., duke i bërë me dije se bazuar në ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm nuk ka më kompetencë në kontrollin e veprimtarisë së prokurorive të rretheve. Në lidhje me këtë kërkesë ankueses i është bërë me dije se për çdo pretendim që lidhet me vendimmarrjet e prokurorëve duhet t’i drejtohet gjykatave pranë të cilave ushtrojnë funksionin prokuroritë.

135. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me ecurinë e çështjeve të sipër përshkruara, si dhe të bënte me dije mbi statusin aktual të tyre.

#### **1. Në lidhje me ankesën nr. \*\*\*, datë 10.8.2018, të shtetasit T. Q.**

##### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

136. Lidhur me ankesën nr. \*\*\*, datë 10.8.2018, të shtetasit T. Q., subjekti ka parashtruar se për këtë çështje, me vendimin e datës 2.4.2018, ka vendosur mosfillimin e hetimeve të materialit kallëzues nr. \*\*\*, me arsyetimin se bazuar në nenin 290, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale nuk provohej fakti i konsumimit të veprës penale. Ndaj këtij vendimi nuk ka rezultuar të jetë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>60</sup>.

##### **Vlerësimi i trupit gjykues**

137. Pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer veprimet verifikuese, të vlerësuara prej saj si të nevojshme dhe të mjaftueshme, ka vendosur mosfillimin e hetimeve.

138. Lidhur me këtë çështje, gjatë hetimit administrativ Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës<sup>61</sup>, e cila vuri në dispozicion vendimin për mosfillimin e hetimeve të materialit kallëzues nr. \*\*\*, viti 2018, lidhur me kallëzimin e shtetasit T. Q. (të përsëritur disa herë), ku në përfundim të verifikimeve është marrë vendimi për mosfillimin e hetimeve, pasi nuk është konstatuar ndonjë fakt i konsumimit të veprës penale “Shkatërrimi i pronës” dhe as nuk janë gjetur elemente të ndonjë vepre tjetër penale.

139. Lidhur me pretendimin e ankuesit se vendimi i dhënë prej tij nuk ka qenë i drejtë, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë nuk referohen shkelje konkrete në drejtim të aftësiwe profesionale të subjektit apo ndonjë provë për korrupsion nga ana e saj sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, por pretendimet e ankuesit i referohen mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e subjektit, Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për

<sup>60</sup> Konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

<sup>61</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2023.



statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, pasi del jashtë tagrave të tij.

140. Ky vlerësim i Komisionit mbështetet edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin citohet: *“54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”.*

## **2. Në lidhje me ankesën nr. \*\*\*, viti 2018, të shtetases F. L.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

141. Subjekti ka parashtruar se me vendimin e datës 31.7.2018 ka vendosur mosfillimin e hetimeve të materialit kallëzues nr. 2174/2018, me arsyetimin se bazuar në nenin 290, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, nuk janë konstatuar elemente të konsumimit të veprave penale.
142. Ndaj këtij vendimi nuk ka rezultuar të jetë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>62</sup>.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

143. Në përfundim të analizimit të materialeve të administruara nga Komisioni, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore dhe veprimeve procedurale, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet verifikuese paraprake sipas kërkesave ligjore për qartësimin e rrethanave në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Për pasojë, në pamundësi për të zëvendësuar logjikën vlerësuese dhe vendimmarrëse të subjektit dhe në mungesë të konstatimit të ndonjë rrjedhe të ndryshme të çështjes në vijimësi, trupi gjykues nuk ka konstatuar shkelje procedurale në vlerësimin e subjektit në lidhje me këtë situatë.

### **C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

144. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim. Për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, Komisioni përgjithësisht nuk ka konstatuar problematika.

### **Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit**

145. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, pas kërkesave të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2022, vuri në dispozicion një praktikë, nga ku rezulton të ketë materiale hetimore në ngarkim të palës shitëse “\*\*\*” sh.p.k., por nuk informoi mbi emrin e prokurorit që e kishte ndjekur atë.

<sup>62</sup> Konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

146. Me qëllim qartësimin e këtij informacioni, në vijim, Komisioni iu ridrejtua përsëri Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2023, informoi se në asnjë nga materialet hetimore ku rezultoi shtetasit/personat fizikë të përmendur, duke përfshirë edhe shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. (në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2022), nuk janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit Teuta Rrudha.
147. Lidhur me shoqëritë “\*\*\*”, “\*\*\*” dhe shtetasit e tjerë të përmendur në këtë shkresë<sup>63</sup> ka rezultuar se nuk ka çështje të regjistruara në ngarkim të tyre.
148. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2022, konfirmoi se në emër të shtetasve<sup>64</sup> nuk ka rezultuar të këtë çështje në ngarkim të tyre.
149. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2023, e cila pas verifikimit të kryer në regjistrat e njoftimit të veprave penale informoi nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2023, se nuk rezultoi që në emër të shoqërive tregtare apo shtetasve të përmendur në këtë shkresë të këtë ndonjë procedim penal.

### DENONCIME

150. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 6 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, siç janë trajtuar në vijim:

#### **1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2022, i shtetasit K. S.**

151. Denoncuesi ka pretenduar se është njoftuar përtej afatit ligjor të parashikuar nga ligji për vendimin e mosfillimit të procedimit penal të datës 15.2.2022, të marrë nga subjekti. Nga shqyrtimi i vendimit objekt kallëzimi<sup>65</sup> ka rezultuar se subjekti në vendimin e marrë, ndër të tjera, ka arsyetuar se bazuar në nenin 66, shkronja “c” e Kodit Penal, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, nuk mund të kryhet ndjekja penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar 5 vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në 5 vjet burgim ose gjobë.
152. Bashkëlidhur dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar edhe shkresa për njoftimin e denoncuesit e datës 18.10.2022, pra mbi 8 muaj me vonesë, përtej afateve ligjore të parashikuara.
153. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqiste shpjegime lidhur me ecurinë e çështjes, si dhe statusin aktual të saj.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

<sup>63</sup> E. K., A. C., A. C., K. Dh., U. K., D. Dh., Gj. Sh., E. K., D. B., A. B., A. K., Sh. G., F. G., P. H., B. H., S.P., M. P., D. P., O. G., E. L. dhe V. L. nuk ka të regjistruar procedime penale në emër të tyre, po ashtu edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2022, ka bërë me dije se lidhur me personat Nj. H., Ll. Gj. dhe D. Gj. nuk ka rezultuar të jenë regjistruar procedime penale.

<sup>64</sup> Nj. H., Ll. Gj. dhe D. Gj.

<sup>65</sup> Administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2023.

154. Subjekti ka sqaruar se me vendimin e datës 15.2.2022 ka vendosur mosfillimin e hetimeve të materialit kallëzues nr. \*\*\*, bazuar në nenin 290, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale, pra nuk është parashikuar ndjekja penale. Nga ana e kallëzuesit është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.3.2023, ka vendosur pranimin e ankimit dhe urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal. Në vijim, subjekti nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi dhe menjëherë pas marrjes dijeni të këtij vendimi ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 8.6.2023, dhe aktualisht hetimet vijnë.
155. Subjekti ka parashtruar se shtetasi K. S. është ankuar edhe pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe ky i fundit, pas shqyrtimit të rastit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2023, ka vendosur “Arkivimin e ankesës”.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

156. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dokumentacionin e administruar për çështjen në analizë, konstatoi se ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kallëzuesi, por për sa kohë kjo është një çështje ende në hetim nuk mund të përbëjë objekt rivlerësimi nga Komisioni. Për më tepër, nisur nga fakti që veprimet e kryera nga subjekti në këtë çështje janë analizuar nga ILD-ja, duke e arkivuar ankesën e rastit në fjalë, evidentohet se nuk janë konstatuar shkelje të kryera nga subjekti.

### **2. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2019, i shtetasit T. Q.**

157. Ky denoncim ka rezultuar me të njëjtën përmbajtje me ankesën e shtetasit T. Q., e cila është trajtuar në kapitullin “Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”<sup>66</sup> – lidhur me të cilën nuk janë evidentuar shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

### **3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2018, i shtetasit F. M.**

158. Në denoncimin e tij ky shtetas u është referuar disa subjekteve të rivlerësimit, ndërmjet tyre edhe për prokuroren Teuta Rrudha, por nuk ka qartësuar apo përshkruar ndonjë shkelje ligjore apo procedurale të ndërmarrë prej saj. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2022. Kjo e fundit vuri në dispozicion një kopje të vendimit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të hetuar nga prokurorja E. Xh. Nga sa më sipër, Komisioni nuk sheh *indicie* për thellimin e hetimit, për aq kohë sa kallëzimi në fjalë nuk është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Teuta Rrudha.

### **4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2018, i shtetases R. K.**

159. Denoncuesja nuk ka përshkruar ndonjë shkelje procedurale të kryer nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezultoi që subjekti të kishte hetuar ndonjë çështje ku të ishte e përfshirë denoncuesja.

---

<sup>66</sup> Referojuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021.

160. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>67</sup> ka përcjellë kopjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, të shtetases R. K., vendim i cili është marrë nga prokurori G. V.

161. Në përfundim, nuk janë evidentuar *indicie* për thellimin e hetimit, për sa kohë kallëzimi në fjalë nuk është shqyrtuar nga znj. Teuta Rrudha.

**5. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2021, i shtetasit nga S. T.**

162. Nga shqyrtimi i denoncimit të paraqitur disa herë nga shtetasi S. T., Komisioni vlerëson se nuk shihen *indicie* për thellimin e tij, për aq kohë sa në të nuk përshkruhen shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit Teuta Rrudha apo rrethana konkrete mbi të cilat do të mund të kryheshin hetime/verifikime më të thelluara.

**6. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2023, i shtetasit E. J.**

163. Denoncuesi ka ngritur pretendime për shkelje procedurale dhe të etikës së prokurorit. Sipas tij, subjekti i rivlerësimit nuk i ka dhënë mundësinë që në fund të hetimit denoncuesi të njihej me dosjen, si dhe nuk ka kryer një hetim të plotë, por ka kryer vetëm veprime që ishin në interes të gjyqtarit E. P.<sup>68</sup>.

164. Nga shqyrtimi i akteve të depozituara me denoncimin ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Durrës kallëzimin penal të paraqitur nga E. P., me detyrë gjyqtar, ndaj shtetasit E. J., për veprën penale “Fyerja e gjyqtarit”<sup>69</sup>. Prokurorja, në datën 27.5.2019, ka njoftuar përfundimin e hetimeve për shtetasin E. J., njoftim i cili është refuzuar prej tij, sipas shënimit të vendimit të oficerëve të policisë gjyqësore të kopjes së vënë në dispozicion. Prej subjektit të rivlerësimit është marrë vendimi për marrjen e personit të pandehur dhe është njoftuar akuza në datën 19.10.2018, si dhe kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Pas shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të shtetasit E. J., për kryerjen e veprës penale “Fyerja e gjyqtarit”.

165. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është paraqitur ankim (dhe ankim shtesë) nga subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës dhe deklarimin fajtor të të dyshuarit (këtu denoncuesi). Denoncuesi pretendon se aktet e ankimit nuk janë hartuar nga prokurorja Teuta Rrudha, por nga E. P. (kallëzuesi), duke pretenduar si fakt provues përdorimin e shkronjave “ë” dhe “ç”, si dhe numrin e fletëve. Pas shqyrtimit të ankimit Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.2.2022, ka vendosur “Ndryshimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe deklarimin fajtor të shtetasit E. J. dhe dënimin e tij me 1 muaj burgim”.

166. Nga sa më sipër, nga shqyrtimi i këtij denoncimi Komisioni nuk vërejtë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë ndonjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale për subjektin. Për më tepër që, pa e shtrirë vlerësimin në themelin e çështjes, vërehet se veprimet hetimore, konkluzionet, kërkesat dhe ankimet e subjektit të rivlerësimit kanë

<sup>67</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2022.

<sup>68</sup> Gjyqtari E. P. kishte paraqitur kallëzimin penal për veprën “Fyerja e gjyqtarit”.

<sup>69</sup> Gjyqtari kishte gjykuar çështjen për pezullimin e titullit të ekzekutimit, pasi kërkesa për përjashtimin e tij nga ky gjykim nuk ishte pranuar nga kryetarja e Gjykatës. Vijimi i shqyrtimit të çështjes prej tij dhe marrja e vendimit është cilësuar si akt kriminal nga shtetasi dhe është botuar edhe në median *online*, duke u bërë shkak për konfliktin.

gjetur miratim dhe mbështetje nga vlerësimi i kryer nga Gjykata e Apelit, sikurse është përshkruar më sipër.

## LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA

### 1. Lidhur me artikullin e publikuar në portalin “\*\*\*.com”<sup>70</sup>

167. Komisioni gjatë hetimit administrativ është vënë në dijeni në lidhje me një artikull të publikuar në median *online* lidhur me të cilin ka kërkuar, administruar dhe analizuar të dhënat dhe dokumentacionin përkatës të fakteve që u referohej ky artikull/shkrim publik.
168. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se në vitin 2017 dy përmbarues, të mbështetur nga punonjësit e policisë, kanë shkuar për të ekzekutuar vendimin gjyqësor që ka pasur si objekt lirim të banesës së dy shtetasve. Shtetasit në fjalë kanë bërë rezistencë dhe në këto rrethana është ndërprerë ekzekutimi i vendimit të Gjykatës për lirim të sendit. Në vijim, këta shtetas kanë paraqitur kallëzim në Komisariatin e Policisë.
169. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës<sup>71</sup> ka bërë me dije se lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2017, është marrë vendimi për mosfillimin e hetimeve në datën 11.9.2017 nga subjekti i rivlerësimit.
170. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me dinamikën dhe ecurinë e çështjes në fjalë, si dhe qartësime mbi statusin aktual të saj.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

171. Subjekti ka parashtruar se lidhur me materialin kallëzues nr. \*\*\*, me vendimin e datës 20.9.2017 ka vendosur mosfillimin e hetimeve, vendim për të cilin ka njoftuar edhe palët e interesuara. Argumentimi ligjor për mosfillimin në rastin konkret ka qenë i mbështetur në nenin 290, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale – pra fakti nuk përbën veprë penale. Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nuk rezulton që ndaj këtij vendimi mosfillimi të jetë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

### Vlerësimi i trupit gjykues

172. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, çmon se subjekti ka ndërmarrë veprimet për verifikime paraprake sipas kërkesave ligjore dhe, kësaj, Komisioni nuk ka evidentuar *indicie* apo fakte mbi shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit për të cilat do të nevojitej një hetim i thelluar nga Komisioni apo që do të mund ta ngarkonin subjektin me përgjegjësi në kuadër të vlerësimit të aktivitetit profesional të saj, për sa i takon çështjes në fjalë.

### 2. Lidhur me artikullin e publikuar në portalin “\*\*\*.al”<sup>72</sup>

173. Pak kohë përpara seancës dëgjimore Komisioni mori dijeni mbi ekzistencën e publikimit të një artikulli në portalin “\*\*\*.al”, me përmbajtjen si vijon: “[...] Në korrik të vitit 2018, Prokuroria e Durrësit ka kërkuar pushimin e çështjes, ndërkohë që A. vijonin të ishin në hetim nga prokuroria e Krimeve të Rënda. Pushimi i çështjes u kërkuar nga Prokuroria e Durrësit në korrik të 2018-ës, ndërkohë që znj. P. u emërua drejtuese të Krimit të Rënda më 9 maj. Duke qenë se kjo çështje u përdor vetëm si sfond politik, prokurores Teuta

<sup>70</sup>[https://\\*\\*\\*.com/\\*\\*\\*](https://***.com/***).

<sup>71</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2023.

<sup>72</sup>[https://www.\\*\\*\\*.al/\\*\\*\\*](https://www.***.al/***)

*Rrudha nuk iu kërkua llogari se përse kërkoi pushim të hetimeve në kohë që Krimet e Rënda hetonin. Të paktën kështu deklaruan, se edhe mund të kenë bërë sikur kanë hetuar. Për prokuroren Teuta Rrudha ende nuk ka nisur Vettingu, por \*\*\*.al është ndalur edhe tek pasuria e saj [...]”.*

174. Ky informacion iu bë me dije subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore, duke i lënë kohë për të paraqitur shpjegimet e saj lidhur me këtë çështje/shkrim. Përgjatë seancës, subjekti shpjegoi ecurinë e kësaj çështjeje, duke parashtruar se në lidhje me dy shtetasit e dyshuar vetëm për njërin prej tyre (shtetasi D. C.) kishin rezultuar prova që të ishte i përfshirë në veprimtari kriminale. Lidhur me shtetasin D. C. subjekti i ishte drejtuar Gjykatës me kërkesë për dërgimin e tij në gjyq, ndërsa për shtetasin tjetër A. B., për të cilin nuk kishte rezultuar asnjë provë që e ngarkonte atë me përgjegjësi penale, subjekti kishte kërkuar pushimin e çështjes.
175. Me kërkesë të trupit gjykues, subjekti u ftua për të paraqitur dokumentacionin lidhur me çështjen në fjalë, duke i dhënë kohë të mjaftueshme për këtë qëllim (sipas vlerësimit të vetë subjektit). Më tej, me anë të postës elektronike të datës 18.10.2023, subjekti paraqiti kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2018, lidhur me procedimin nr. \*\*\*, viti 2018, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar nga Gjykata dërgimin në gjyq të të pandehurit D. C., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake në ambiente të hapura për publikun”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Po me këtë kërkesë, subjekti i kishte kërkuar Gjykatës pushimin e ndjekjes penale në ngarkim të shtetasit A. B., i cili fillimisht kishte qenë i dyshuar për të njëjtën vepër.
176. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 12.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me anë të të cilit është vendosur pranimi i kërkesës së subjektit për dërgimin në gjyq të të pandehurit D. C., si dhe pranimi i kërkesës së prokurores Teuta Rrudha për pushimin e ndjekjes penale për shtetasin A. B. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 16.10.2018, më anë të të cilit është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit D. C. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 31.10.2018.
177. Sikurse u parashtrua më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezultoi se të dyja kërkesat e subjektit të rivlerësimit janë miratuar/pranuar nga Gjykata.
178. Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, duke konsideruar se faktet përkonin me sa u deklarua në seancë nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se nuk kanë rezultuar problematika lidhur me aktivitetin profesional të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket respektimit të të drejtave të palëve dhe hapave procedurale.
179. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim të të drejtave të palëve apo të dispozitave që përcaktojnë hapat proceduralë e, kësisoj, znj. Teuta Rrudha vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Teuta Rrudha:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Teuta Rrudha, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 23.10.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Relator**

**Etleda ÇIFTJA**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Jonida Vrana*